

1 E hënë, 17 korrik 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare e Gjykatës, mund të paraqisni çështjen.

7 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Kjo është
8 çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër
9 Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup
10 Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 Dhe mirëmëngjesi të gjithëve, mirë se erdhët. Do të
13 vazhdojmë me dëshminë e dëshmitarit 04746. Vërej për
14 procesverbalin, z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi
15 janë të pranishëm fizikisht në sallën e gjyqit.

16 Sekretare, mund të sillni dëshmitarin brenda në sallë.

17 [Dëshmitari vijon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të

19 uleni.

20 Mirëmëngjesi, Dëshmitar.

21 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të

23 vazhdojmë me dëshminë tuaj sot. Ju kujtoj t'u përgjigjeni
24 pyetjeve qartë me fjali të shkurtra. Nëse nuk e kuptoni
25 pyetjen, lirisht kërkoni që avokati ta përsërisë ose thoni

1 thjesht që nuk e kuptoni në mënyrë që ta sqarojnë.

2 Gjithashtu, mos harroni të na thoni ku e bazoni dijeninë
3 tuaj lidhur me faktet dhe rrethanat për të cilat do t'ju bëjnë
4 pyetje.

5 Ju kujtoj dhe një herë se e keni ende detyrimin për të
6 thënë të vërtetën sikurse vetë e shprehët përmes deklaratës
7 solemne.

8 Mos harroni të flisni para mikrofonit dhe prisni pesë
9 sekonda përpara se të jepni përgjigje. Flisni ngadalë në
10 mënyrë që t'ju ndjekin dhe përkthyesit.

11 Nëse keni nevojë për ndonjë pushim, na thoni.

12 Do të vazhdojmë tani me kundrapyetjet nga Mbrojtja e z.
13 Veseli.

14 Z. Emmerson, fjala është për ju.

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] Mirëmëngjes.

16 DËSHMITARI: W04746 [Vijon]

17 Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson

18 [Vazhdim]

19 Z. EMMERSON: [Përkthim]

20 PY. Z. Mustafa, kam dy aspekte goxha të kufizuara dhe të
21 shkurtra të cilat dua t'i trajtoj sot paradite me ju. E para
22 lidhet me takimin për të cilin dhe dëshmi ditën e premtë, që
23 filloi me fjalimin nga Ramush Haradinaj, edhe shkrepit dhe
24 automatikun për të tërhequr vëmendjen.

25 Unë ju bëra disa pyetje ditën e premtë lidhur me këtë

1 takim, veçanërisht, sa i takon Bislim Zyrapit dhe për faktin
2 se kishte sugjerime apo propozime se ai do të ishte personi më
3 i përshtatshëm për të qenë komandanti i UÇK-së sesa Azem Syla.
4 Pra, më i përshtatshëm sesa Azem Syla. Dhe unë kur ju bëra
5 pyetjen, thashë:

6 "...është e drejtë kur them Bislim Zyrapit u promovua, u
7 ngrit në detyrë pas këtij takimi?"

8 Dhe ju u përgjigjët disi në mënyrë të vagullt dhe thatë:

9 "Edhe muj ta them kështu".

10 "Edhe mund ta themi kështu."

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] Dhe për këtë, për ata që na
12 ndjekin, ka qenë në transkript në faqen 5781.

13 PY. Znj. Lawson u ngrit në këmbë në atë momente dhe tha që
14 është nevoja ta sqarojmë pak përgjigjen. Prandaj, për ta
15 sqaruar këtë përgjigje unë dua ta bëj edhe një herë pyetjen.

16 Para Rambujesë, para se të ndodhte Rambujeja, Azem Syla
17 ishte komandanti i përgjithshëm i UÇK-së, kështu?

18 PË. Unë nuk e kam ditë këtë.

19 PY. E kuptoj. Por tani a e di që kështu ka qenë?

20 PË. Po, tani po.

21 PY. Thoni që nuk e dije. Por a është e vërtetë se Azem Syla
22 qëndronte në Tiranë gjatë gjithë kohës së konfliktit, pra
23 bazën e ka pasur në Tiranë gjatë konfliktit?

24 PË. Po.

25 PY. Nuk është dikë që e keni ndeshur në Kosovë, apo jo?

1 Flasim për gjatë këto dy viteve.

2 PË. Dy vite të luftës, po.

3 PY. Po.

4 PË. Po, në Tiranë ka qëndru.

5 PY. Dhe nuk ka qenë ushtarak, apo jo?

6 PË. Ne e kemi llogaritur që ai po punon në logjistikën e

7 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

8 PY. Logjistikën.

9 PË. Unë personalisht.

10 PY. Pra, si komandant në terren, ju personalisht, ju nuk

11 kishit ide kush kishte marrë rolin e komandantit të UÇK-së nga

12 Shtabi i Përgjithshëm?

13 PË. Saktë.

14 PY. Asokohe, Bislime Zyrapi, të cilin e njihje besoj, edhe që

15 ishte ushtarak, pra Bislime Zyrapi kishte rolin e shefit të

16 shtabit, kështu është?

17 PË. Po.

18 PY. Pra, në fakt, ishte një person me përvojë ushtarake

19 brenda Shtabit të Përgjithshëm, dhe merakun jua ishte që në

20 krye të Shtabi i Përgjithshëm duhet të kemi një ushtarak,

21 kështu?

22 PË. Kam menduar që duhet, që mundet Bislime Zyrapi me qenë

23 komandant.

24 PY. Tani, gjatë Rambujesë dhe menjëherë pas Rambujesë,

25 anëtarët ekzistues të Shtabit të Përgjithshëm u transferuan në

1 role të reja në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës, a është
2 kështu?

3 PË. Po.

4 PY. Në thelb, pjesë e pasojave të marrëveshjes së Rambujesë
5 ishte formimi i një qeverie të përkohshme për Kosovën që të
6 merrte përsipër përgjegjësinë politike kur përfundoi
7 konflikti?

8 PË. Po.

9 PY. Gjatë këtij procesi, disa persona ndryshuan edhe rolet e
10 tyre, apo nuk është kështu?

11 PË. Po, ashtu është.

12 PY. Azem Syla u bë Ministri i Mbrojtjes, është e vërtetë
13 kështu? Flasim për Qeverinë e Përkohshme.

14 PË. Po.

15 PY. Bislim Zyrapi u bë shef shtabi -- kabineti në Ministrinë
16 e Mbrojtjes, kështu? Shef shtabi në Ministrinë e re të
17 Mbrojtjes?

18 PË. Po.

19 PY. Kur ju pyeta ditën e premte dhe ju thashë që Bislim
20 Zyrapi u ngrit në detyrë pas takimit, më duket se je
21 përgjigjur dhe ke thënë "Ka mujtë me qenë kështu", "Mund ta
22 themi dhe kështu". Pra, a mund të themi që kështu ndodhi sepse
23 u bë shef shtabi i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës në
24 Ministrinë e Mbrojtjes?

25 PË. Mund dhe me thanë.

1 PY. [Nuk ka përkthim].

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] Mund të kalojmë në seancë private
3 për temën e fundit. Sepse ka të bëjë me përgjimet e thirrjeve
4 telefonike që i përmendi dhe Prokurori dhe tha që dëshiron të
5 përmenden në seancë private.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në
7 seancë private.

8 [Seancë private]

9 [Seancë private teksti i fshirë]

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25 [Seancë e hapur]

1 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A e dini se
3 çfarë duhet të shfaqim për publikun?

4 Z. EMMERSON: [Përkthim] Asgjë nuk duhet të shfaqë. Unë do
5 ta lexoj nga transkripti.

6 PY. Z. Mustafa, do ta përsëris edhe një herë pyetjen edhe
7 përgjigjen që patëm gjatë seancës private një çast më parë.
8 Dhe thjesht do ju kërkoj ta konfirmoni, ta pohoni ose jo.

9 Pyetja ime:

10 "A ishit në dijeni asokohe që disa nga anëtarët e Shtabit
11 të Përgjithshëm, përveç Azem Sylës për të cilin biseduam,
12 qëndronin jashtë Kosovës për pjesën më të madhe të konfliktit,
13 veçanërisht nga nëntori dhe marsi, pra nëntori i 1998 dhe
14 marsi i 1999.

15 "PË. Të gjithë qëndronin jashtë vendit me përjashtim të
16 Jakup Krasniqit, Ramë Bujës dhe komandantëve të zonave. Të
17 gjithë të tjerët qëndronin jashtë vendit."

18 Ju kujtohet që na e dhatë këtë përgjigje? A mund ta
19 pohoni për publikun në seancë publike që përgjigjja juaj ishte
20 e saktë, dhe unë lexova përgjigjen tuaj të vërtetë?

21 PË. Po.

22 PY. Faleminderit.

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] Kaq ishin pyetjet nga ana ime.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
25 z. Emmerson.

1 Z. Roberts, e morëm edhe shënimin tuaj. Faleminderit që
2 na informuat.

3 Z. ROBERTS: [Përkthim] Thjesht për të konfirmuar që unë
4 nuk kam pyetje për të bërë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kush do t'i
6 bëjë pyetjet nga ana e ekipit tjetër?

7 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Unë do t'i bëj pyetjet.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
9 Alagendra, sapo të jenë gati mund të vazhdoni.

10 Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra:

11 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

12 PY. Mirëmëngjesi, z. Mustafa. Unë jam znj. Alagendra. Jam
13 Mbrojtja e Jakup Krasniqit. Kam disa pyetje për ju.

14 Ju e njihni z. Jakup Krasniqi, apo jo z. Mustafa?

15 PË. Po.

16 PY. Z. Krasniqi ka qenë mësues dhe profesor i historisë para
17 luftës, apo jo?

18 PË. Z. Krasniqi njihet si intelektual i madh, i lëvizjes
19 kombëtare shqiptare në Kosovë. Ka qenë mësues, ka qenë edhe
20 aktivist politik.

21 PY. Faleminderit. Si politikan, u bë edhe zëdhënës i
22 Parlamentit, kështu?

23 PË. Po, ishte Kryetar i Parlamentit të Kosovës.

24 PY. Është e drejtë të themi që z. Krasniqi është një person i
25 respektuar në Kosovë, apo jo z. Mustafa?

1 PË. Mundem me thanë që është prej figurave ma të respektuara
2 në Republikën e Kosovës.

3 PY. Flasim për periudhën para luftës. Dihej gjithandej që z.
4 Krasniqi ka qenë anëtar i LDK-së, kështu?

5 PË. Po.

6 PY. Dhe ai, sikurse edhe ju, dhe shumë të tjerë donit një
7 Kosovë të fortë dhe të bashkuar, të mos kishte përndjekje,
8 kështu?

9 PË. Jakup Krasniqi atëherë ishte aktivist i madh politik. Dhe
10 ai po krijonte dhe po përhapte besim te gjenerata ime dhe
11 shumë të tjerëve. Por Jakup Krasniqi ka qenë këmbëngulës për
12 t'u bërë Kosova e lirë.

13 PY. Disa herë keni thënë që UÇK-ja nuk ishte një ushtri me
14 persona të stërvitur, por një ushtri me vullnetarë, kështu?

15 PË. Po.

16 PY. Edhe kishte vështirësi gjatë gjithë luftës që të
17 organizohej dhe asnjëherë nuk e arriti strukturën e një
18 ushtrie të rregullt, a është kështu?

19 PË. Ashtu është.

20 PY. Në përgjithësi, kur personat ktheheshin, shkonin në
21 regjionet e tyre ku njihnin dhe terrenin, edhe fshatrat,
22 kështu?

23 PË. Po. Përgjithësisht, po.

24 PY. Ishte krejt e natyrshme dhe kishte thjesht kuptim që këta
25 persona të shkonin në terrenin dhe në fshatrat që njihnin më

1 shumë, a është kështu?

2 PË. Saktë.

3 PY. Shtëpia juaj ishte në zonën e Llapit, z. Mustafa?

4 PË. Po.

5 PY. A është dhe kjo arsyeja pse fillimisht ju shkuat në atë
6 zonë?

7 PË. Po.

8 PY. Do t'ju përmend disa emra. A mund të konfirmoni nëse këta
9 ushtarë të UÇK-së ishin po ashtu nga zona e Llapit? Do të
10 filloj me z. Kadri Kastrati, ishte nga Llapi?

11 PË. Po.

12 PY. Nuredin Ibishi?

13 PË. Po.

14 PY. Latif Gashi?

15 PË. Po.

16 PY. Nazif Mehmeti?

17 PË. Po.

18 PY. Naim Kadriu?

19 PË. Po.

20 PY. Hyzri Talla?

21 PË. Po.

22 PY. Fatmir Humolli?

23 PË. Të gjithë ishin nga regjioni ku po luftonin.

24 PY. Faleminderit. Gjatë kësaj kohe, për shkak të mungesës së
25 organizimit dhe që s'kishte burime, personat në këtë ushtri

1 vullnetare shpesh i blinin vetë uniformat, a është kështu?

2 PË. Po. I blinin, dikush i ndërtonte vetë, i mballonte vetë
3 si i themi ne, e disa të tjerë edhe furnizoheshin.

4 PY. Në fakt, ndonjëherë blinin edhe armët vetë, kështu?

5 PË. Po.

6 PY. Kjo ishte për faktin që UÇK-ja s'i kishte pajisjet e
7 nevojshme dhe gjatë gjithë kohës kishte vështirësi që të
8 formohej siç duhej për çlirimin e Kosovës, kështu z. Mustafa?

9 PË. Sigurisht.

10 PY. Javën e kaluar, ju bënë pyetje çfarë roli kishte Jakup
11 Krasniqi në Shtabin e Përgjithshëm, edhe ju u përgjigjët se
12 ishte zëdhënësi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ju kujtohet
13 që e dhatë këtë përgjigje?

14 PË. Po.

15 PY. Gjatë luftës ju e njihnit si zëdhënësi, apo jo?

16 PË. Po.

17 PY. I bie pas qershorit 1998 më konkretisht?

18 PË. Gjatë gjithë kohës së luftës, unë Jakup Krasniqin e kam
19 njohur si zëdhënës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

20 PY. Në rregull. Më pas, Prokurorja ju bëri pyetje në qoftë se
21 ka pasur ndonjë periudhë kur z. Krasniqi ka pasë një rol të
22 dytë. Dhe ju u përgjigjët, se keni parë dokumente ku e
23 përshkruanin edhe si zëvendës. Ju kujtohet kjo?

24 PË. Po, këto kanë ndodhë ma vonë.

25 PY. E keni të qartë këtë, z. Mustafa, po. Pastaj Prokurorja

1 ju bëri pyetje të sqaroni çfarë deshët të thonit me fjalën
2 "zëvendës", a ishte zëvendëskomandant i UÇK-së në përgjithësi.
3 A ju kujtohet kjo pyetje?

4 PË. Unë kam pa dokumente edhe sidomos është dëgju fjala prej
5 sa është formu Gjykata Speciale, se Jakup Krasniqi paska qenë
6 zëvendës i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Mund të ndodhë që
7 ka qenë, por unë nuk e kam njohur ashtu.

8 PY. Gjithashtu nuk është ditur publikisht me sa dini ju që z.
9 Krasniqi të ketë qenë zëvendëskomandant i UÇK-së. A është e
10 saktë, a është e drejtë ta themi kështu? Gjatë luftës.

11 PË. Unë s'e kam njoftë, besoj s'e kanë njoftë as të tjerët si
12 zëvendëskomandant.

13 PY. Qartë. Shohim librin e Skënder Zhitias. Ua kanë treguar
14 disa herë këtë libër gjatë dëshmisë suaj.

15 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Dhe referenca për këtë
16 SPOE00055736 deri në 55742-ET Revised. Faqja konkrete është
17 55741. Besoj se edhe shqipja ka të njëjtin numër reference,
18 55678 deri 56018. Faqja konkrete është 55741, deri në 55742.

19 PY. Do doja të shihnim te shqipja fundin e faqes, anglishtja
20 është paragrafi i fundit i dokumentit 55741. A mund ta shihni
21 ju lutem paragrafin e fundit, z. Mustafa, për një çast?

22 PË. Po, veç jam duke e parë.

23 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Kalon dhe faqen tjetër që
24 mbaron me 42 në shqip.

25 PY. Sipas këtij paragrafit të librit, më 12 nëntor janë bërë

1 disa emërime. E shihni?

2 PË. Po, po shihet nga ky shkrim po shihet që po.

3 PY. z. Mustafa, këtu thuhet që z. Krasniqi ka qenë një nga dy
4 zëvendëskomandantët e përmendur, saktë?

5 PË. Ashtu po shkruan këtu.

6 PY. Thuhet që zëvendëskomandantët ishin zëvendëskomandanti
7 për Drejtorinë Operative, Sokol Bashota, dhe
8 zëvendëskomandanti për Mbështetjen, Jakup Krasniqi. Kështu
9 thuhet tek libri, apo jo?

10 PË. Po.

11 PY. Z. Krasniqi, sipas këtij libri, zëvendësi i komandantit
12 për Mbështetjen. Dhe ndryshimi mes tyre, z. Mustafa, ishte që
13 Jakup Krasniqi trajtonte mbështetjen dhe aspektet politike, jo
14 aspektet operative, kështu është apo jo?

15 PË. Kështu po e kuptoj, edhe si mbështetës politik i Ushtrisë
16 Çlirimtare të Kosovës e kam njohë gjithherë.

17 PY. Po ashtu jeni në dijeni që z. Krasniqi nuk ka përvojë
18 ushtarake, kështu?

19 PË. Po.

20 PY. Dua t'ju tregoj një dokument tjetër, SPOE00229217,
21 shqipja me të njëjtën numër reference, por mbaron me 229218.

22 Ky është një dokument me shkrim dore që flet për
23 mbledhjen e 12 nëntorit 1999 të cilit i referohet dhe libri,
24 ai paragrafi që lexuam pak më herët. E shihni që në këtë
25 dokument flitet për Jakup Krasniqin si zëvendëskomandanti për

1 Mbështetje? Thuhet në këtë dokument.

2 PË. Po, e shoh.

3 PY. A përputhet kjo me informacionin që keni marrë ju pas
4 luftës, sa i takon rolit tjetër që mendoj se ka pasur z.

5 Krasniqi?

6 PË. Po.

7 PY. Po ashtu thuhet në fund të faqes që:

8 "Grupi politik për bisedimet është emëruar, është
9 krijuar".

10 Dhe përmend emrat Jakup Krasniqi, Sokol Bashota dhe Ramë
11 Buja." Kështu e keni ditur dhe ju?

12 PË. Nuk e kam ditë unë në atë kohë. S'besoj që e kam -- për
13 Sokol Dobrunën dhe, ka emra për të cilat nuk e kam ditë që
14 janë urdhëru në këto pozicione. Për Jakup Krasniqin e kam ditë
15 gjithherë.

16 PY. Faleminderit. Ditën e premte, ju treguan edhe një libër
17 tjetër nga -- konkretisht, ekipi i Mbrojtjes së z. Thaçi,
18 ishte "Një rrëfim për luftën dhe lirinë."

19 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Edhe ishte me numër reference
20 U0176046 deri 6049, Prova materiale ID25 -- 1D0025. Ju kërkoj
21 ndjesë, ky është numri i saktë. Numri i faqes U0176048.
22 Versioni në shqip, është numri i njëjtë me shtesën AT në fund,
23 pra numri është K0238068.

24 PY. Ju lutem, lexoni pjesën që fillon me fjalët:

25 "Sfera e influencës së Demaçit mbi komandantët e zonës

1 nuk ishte vendimtare...”

2 Ju lutem, filloni të lexoni atë pjesë. Fillon me “Sepse
3 fuqia ndikuese e Demaçit...” domethënë nga ajo fjali.

4 PË. Mund të lexoj?

5 PY. [Nuk ka përkthim]

6 PË. “Sepse fuqia ndikuese e Demaçit te komandantët e zonave,
7 nuk ishte edhe vendimtare. Nuk them se nuk ishte pa vlerë, por
8 vendimtare jo. Komandantët e zonave kanë vepruar me kokën e
9 vet. Me logjikën e tyre si ushtarë, si luftëtarë dhe si
10 qytetarë të Kosovës.”

11 PY. Dhe vazhdon:

12 “Edhe diçka duhet pasur parasysh: Në Rambuje ka qenë
13 Jakup Krasniqi që ishte zëdhënës i Shtabit të Përgjithshëm të
14 UÇK-së”.

15 A është kështu?

16 PË. Po.

17 PY. Dhe roli i z. Krasniqi në atë delegacion që shkoi në
18 Rambuje, ishte i njohur publikisht në atë kohë, domethënë si
19 zëdhënës i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të
20 Kosovës. A është kjo e saktë?

21 PË. Saktë.

22 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Tani, shikoni dokumentin me
23 numër SPOE00054541. Është numri i njëjtë edhe në versionin
24 shqip.

25 PY. Z. Mustafa, a ju kujtohet kur u anoncua Qeveria e

1 Përkohshme më 2 prill 1999?

2 PË. Po.

3 PY. Dhe me këtë shpallje, Qeveria e Përkohshme e Kosovës
4 përfshinte z. Krasniqi si zëdhënës të qeverisë të përkohshme,
5 a është kjo e saktë?

6 PË. Po.

7 PY. Megjithëse përbërja e Qeverisë së Përkohshme u shpall më
8 2 prill të vitit 1999, në këtë marrëveshje thuhet se kishte
9 pasë një marrëveshje që ishte arritë më datën 23 shkurt 1999.
10 A është kjo e saktë?

11 PË. Kështu po shkruan libri.

12 PY. Dhe pas emërimit të tij si zëdhënës i Qeverisë së
13 Përkohshme, z. Krasniqi mbeti në atë pozitë, në atë post deri
14 pas luftës. A është kjo e saktë?

15 PË. Po.

16 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Tani do t'ju tregohet një
17 dokument tjetër me numër SPOE00224611 deri 612-ET. Numri është
18 i njëjtë edhe për versionin shqip.

19 PY. Sot në mëngjes në përgjigje të pyetjes së z. Emmerson, ju
20 u përgjigjët se mes nëntorit 1998 dhe marsit 1999, po ua lexoj
21 përgjigjen që e dhatë sot në mëngjes:

22 "Të gjithë ata qëndruan jashtë vendit me përjashtim të
23 Jakup Krasniqit dhe Ramë Bujës..."

24 A ju kujtohet kjo që e thatë në mëngjes?

25 PË. Po.

1 PY. E dinit në atë kohë, z. Mustafa, apo jo se gjatë mesit të
2 marsit 1999, më konkretisht më 19 mars 1999, z. Krasniqi shkoi
3 në Tiranë dhe nuk ishte në Kosovë?

4 PË. Po, këtë kohë e dimë. Gjatë kohës së bombardimeve ashtu
5 është, në Tiranë ka qenë.

6 PY. Dhe sipas kësaj deklarate të bërë më 4 qershor të vitit
7 1999, z. Krasniqi ishte asokohe ende në Tiranë, a është kjo e
8 saktë?

9 PË. Po.

10 PY. Dhe në verën e vitit 1999, do të pajtoheni me mua apo jo
11 se z. Krasniqi u emërua si ministër për rindërtim dhe
12 zhvillim, a është kjo e saktë?

13 PË. Po.

14 PY. Dhe këtë emërim nuk e bëri UÇK-ja, apo jo? Por e bëri
15 Lëvizja e Unionit Demokratik [sipas përkthimit], LBD-ja, a
16 është kjo e saktë?

17 PË. Nuk e di kush, por unë e se ka qenë ministër në atë kohë
18 z. Jakup Krasniqi.

19 PY. Dhe si ministër për rindërtim dhe zhvillim, ai ka punuar
20 me çështje prioritare, parësore, siç kanë qenë për shembull
21 vlerësimi i dëmeve të luftës dhe ringjallja e industrisë,
22 rindërtimi i industrisë. A e dini për këtë?

23 PË. Unë e di se në atë kohë Jakup Krasniqi ka qenë ministri
24 ma i suksesshëm në qeverinë e Kosovës. Detaje të tjera nuk po
25 i di tash.

1 PY. Faleminderit. Javën e kaluar, i thatë gjykatës se LDK-ja
2 e ka mbështetur luftën çlirimtare në rajonin e juaj. A ju
3 kujtohet kjo përgjigje?

4 PË. Po.

5 PY. Ju vetë, z. Mustafa, keni qenë anëtar i forumit rinor të
6 LDK-së, a është kjo e saktë?

7 PË. Po.

8 PY. Dhe ka pasë edhe anëtarë të tjerë të LDK-së që kanë qenë
9 në UÇK. A është kjo e saktë?

10 PË. Po.

11 PY. Dhe prej 1995 deri në prill të vitit 1998, Z. Krasniqi
12 vetë ishte anëtar i LDK-së, më konkretisht ishte kryetar i
13 këshillit arsimor në Drenas, a është kjo e saktë?

14 PË. Po, gjithherë me punë rreth arsimit dhe edukimit ka punue
15 [E padëgjueshme] -- edhe ka qenë në Lidhjen Demokratike ku
16 isha edhe unë.

17 PY. Gjithashtu, përmendet edhe -- në fakt ju i dhatë detyra
18 Muhamet Latifit, Shefki Gashit dhe disa anëtarëve të tjerë apo
19 aktivistëve të tjerë të LDK-së për të mbështetur luftën, a
20 është kjo e saktë z. Mustafa?

21 PË. Gjithë udhëheqësit politikë të LDK-së në Podujevë,
22 Prishtinë, dhe Fushë Kosovë kanë qenë logjistikë e UÇK-së.

23 PY. Edhe mbas luftës, anëtarët e UÇK-së iu bashkëngjitën
24 partisë së LDK-së, apo jo z. Mustafa?

25 PË. Po, më pas, gjithsecili është kthye aty ku ka besue.

1 PY. Dhe një nga ata që iu bashkuan LDK-së ishte Nuredin
2 Ibishi.

3 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Dhe tani kërkoj dokumentin
4 DJK00205, ju lutem.

5 PY. Z. Nuredin Ibishi iu bashkua LDK-së, apo jo z. Mustafa?

6 PË. Po.

7 PY. Dhe në këtë fotografi shihet që ai ka përdorë nofkën që e
8 ka pasë gjatë luftës, Leka, a është e saktë?

9 PË. Po.

10 PY. Tani do të kaloj tek periudha e shkurtër e kohës që keni
11 qenë në Shtabin e Përgjithshëm. Prokurori ju bëri pyetje më
12 datën 13 korrik se "kush ju emëroi apo kush ju tha që të
13 shkonit dhe t'i bashkoheshit Shtabit të Përgjithshëm?", dhe ju
14 u përgjigjët se ky ishte shefi i shtabit Bislime Zyrapi, pastaj
15 Prokurori ju bëri pyetje, "a ka mund të ketë qenë dikush
16 tjetër t'ju emërojë në atë pozitë?" Dhe ju u përgjigjët "në
17 qoftë se jo vetë Bislime Zyrapi, mund të ketë qenë z. Krasniqi
18 që ma ka komunikuar atë vendim". Kjo ishte përgjigja juaj që
19 dhatë më 13 korrik. A ju kujtohet?

20 PË. Kur unë e kam thënë që ka mujtë me kanë z. Krasniqi që ma
21 ka komunikuar, por nuk më kujtohet me saktësi tani.

22 PY. Domethënë nuk jeni i sigurt për këtë, z. Mustafa?

23 PË. Nuk jam i sigurt, me z. Jakup Krasniqi kam komunikuar me
24 lehtësi në të gjitha kohët edhe tani s'më kujtohet gjithçka.
25 Por me Jakup Krasniqi kam folë gjithçka.

1 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Tani do ta diskutoj me ju një
2 pjesë të intervistës suaj me Prokurorinë, numri i dokumentit
3 është 082894-TR-ET Pjesa 2, faqja 16. Versioni në shqip është
4 numri i njëjtë, Pjesa 2, faqja 18, rreshtat 20 dhe pastaj
5 faqja 19 rreshti 2. Në versionin në anglisht janë rreshtat 3
6 deri në 9.

7 PY. Në faqen 18, rreshti 20, z. Mustafa në versionin në shqip
8 e keni. Dhe vazhdon deri në faqen në vijim, rreshtat 1 dhe 2.
9 Domethënë prej faqes 18, rreshti 20, deri në 19, rreshtat 1,
10 2.

11 Dhe Prokurori ju pyet:

12 "Kur keni marrë pjesë në këto takime, nga Shtabi i
13 Përgjithshëm a kanë qenë të njëjtët persona gjithnjë, apo ka
14 ndryshuar?"

15 Dhe përgjigjja juaj është:

16 "Nuk do të thotë gjithherë, por unë e di që natyrën
17 ushtarake dhe riorganizimin e ka udhëheqë gjithherë Bislim
18 Zyrapi. Kur ka pasë çështje politike që janë diskutuar, ka
19 marrë pjesë edhe Jakup Krasniqi. Ka pasë edhe njerëz të tjerë
20 por nuk e di."

21 A mund të konfirmoj me ju, z. Mustafa, se pjesëmarrësit
22 në ato takime nuk kanë qenë gjithmonë të njëjtët, a është kjo
23 e saktë?

24 PË. E saktë.

25 PY. Dhe nuk ju kujtohet saktësisht se kush ka qenë i

1 pranishëm në cilin takim, domethënë nuk ju kujtohet se kush ka
2 qenë çdo herë i pranishëm nëpër takime?

3 PË. Saktë.

4 PY. Dhe a është e saktë se z. Krasniqi nuk ka qenë i
5 pranishëm në të gjitha mbledhjet ku keni qenë ju vetë i
6 pranishëm? Mbledhjet e Shtabit të Përgjithshëm.

7 PË. Po.

8 PY. Dhe z. Krasniqi ka marrë pjesë në disa takime kur janë
9 diskutu aspekte politike, çështje politike, a është kjo e
10 saktë?

11 PË. Po, si e kam thanë është.

12 PY. Javën e kaluar, Prokurori ju pyeti nëse keni qenë i
13 pranishëm në një mbledhje të Shtabit të Përgjithshëm ku janë
14 diskutu bashkëpunëtorët.

15 Do ta përsëris pyetjen. Prokurori ju pyeti nëse keni qenë
16 i pranishëm në mbledhjen e Shtabit të Përgjithshëm ku janë
17 diskutua bashkëpunëtorët. A ju kujtohet kjo pyetje që ua bëri
18 Prokurori?

19 PË. Po, po. Më kujtohet.

20 PY. Dhe ju u përgjigjët se nuk ju kujtohet asnjë gjë e tillë
21 se:

22 "Kishte shumë çështje më të rëndësishme për ne."

23 A ju kujtohet kjo përgjigje që e dhatë?

24 PË. Po.

25 PY. Pastaj Prokurori ju pyeti se cilët anëtarë të Shtabit të

1 Përgjithshëm ishin të pranishëm në takimin kur është diskutu
2 çështja e bashkëpunëtorëve dhe ju u përgjigjët se nuk ju
3 kujtohen hollësi në lidhje me takime të tilla. Megjithatë, ka
4 shumë pak mundësi që z. Jakup Krasniqi të ketë qenë i
5 pranishëm në një takim ose takime të tilla. Pra, se ka shumë
6 pak mundësi që ai të ketë qenë i pranishëm. A ju kujtohet kjo
7 përgjigje?

8 PË. Ka mujë... saktë mu s'më kujtohet, por ashtu mendoj edhe
9 sot. Ashtu mendoj edhe sot.

10 PY. Atëherë ta qartësoj, z. Mustafa. Nuk ju kujtohet juve
11 personalisht një takim apo takime të tilla ku është diskutu
12 çështja e bashkëpunëtorëve, a është kjo e saktë?

13 PË. Po.

14 PY. Dhe gjithashtu nuk ju kujtohet të jetë mbajtur një
15 mbledhje e tillë ku kanë qenë të pranishëm anëtarë të Shtabit
16 të Përgjithshëm. A është kjo e saktë?

17 PË. Saktë.

18 PY. Dhe në qoftë se është mbajtur një takim i tillë, ju vetë
19 nuk ju kujtohen saktësisht emrat e atyre që kanë qenë të
20 pranishëm në atë mbledhje. A është kjo e saktë?

21 PË. Saktë.

22 PY. Dhe në qoftë se është mbajtur një mbledhje e tillë, juve
23 nuk ju kujtohet se çfarë është diskutu në hollësi, a është kjo
24 e saktë?

25 PË. Saktë.

1 PY. Dhe gjithashtu, nuk ju kujtohet të keni marrë ndonjë
2 dokument në një takim të tillë, a është kjo e saktë, z.
3 Mustafa?

4 PË. Po.

5 PY. Dhe në qoftë se e keni marrë ndonjë dokument, një takim
6 të tillë, juve nuk ju kujtohet se për çfarë ka qenë ai
7 dokument. A është kjo e saktë?

8 PË. Po.

9 PY. Dhe gjithashtu nuk ju kujtohet në qoftë se ju është kërku
10 që të shpërndani një dokument të tillë ose jo. A është kjo e
11 saktë.

12 PË. Po.

13 PY. Pra, e vërteta z. Mustafa, është se juve nuk keni një
14 kujtesë të qartë për ndonjë takim ku të jenë diskutu
15 bashkëpunëtorët. A është kjo e saktë?

16 PË. Po.

17 PY. Dhe kur thatë më herët që ka shumë pak mundësi të ketë
18 qenë z. Krasniqi i pranishëm, ju vetë nuk jeni i sigurt në
19 qoftë se është mbajtur një takim i tillë. A jeni i sigurt apo
20 jo?

21 PË. [E padëgjueshme]

22 PY. Gjithashtu, nuk ju kujtohet nëse z. Krasniqi ka qenë i
23 pranishëm në ndonjë takim ku janë diskutu bashkëpunëtorët. A
24 është kjo e saktë?

25 PË. Po.

1 PY. Dhe dëshmia juaj që z. Krasniqi mund të ketë qenë i
2 pranishëm bazohet në faktin se z. Krasniqi ka marrë pjesë në
3 disa takime të Shtabit të Përgjithshëm. A është kështu?

4 PË. Ashtu duhet të jetë.

5 PY. Ju na thatë më herët se i keni nda gjithë gjanat
6 domethënë, keni bisedu lirisht me z. Krasniqi. Sa për të qenë
7 të qartë z. Mustafa, këto janë çështje domethënë, kjo afërsi
8 kishte të bënte me aspekte të shoqërisë, jo me gjana që
9 lidheshin me luftën. A është kjo e saktë?

10 PË. Në aspekte të besimit, unë kam besue dhe besoj në z.
11 Jakup Krasniqi.

12 PY. Faleminderit.

13 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Nuk kam më pyetje të tjera, të
14 nderuar Gjykatës.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

16 A keni pyetje që dalin nga pyetjet e Mbrojtjes, znj.
17 Lawson?

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, faleminderit.

19 Pyetje vijuese nga znj. Lawson:

20 PY. Mirëmëngjesi, z. Mustafa. Mbrojtja të premtën ju pyeti në
21 lidhje me anëtarësinë tuaj në forumin rinor të LDK-së, dhe kjo
22 pyetje u bë edhe sot. LDK-ja, a ishte një organizatë e
23 ligjshme -- legale apo ilegale?

24 PË. Të gjitha subjektet shqiptare kanë qenë legale për ne.
25 Ilegale kanë qenë vetëm forcat armike, institucionet që

1 prezantonte Serbia, shteti serb.

2 PY. Përfshirja juaj në forumin rinor të LDK-së, ishte diçka
3 publike?

4 PË. Po.

5 PY. Po ashtu të premtën thatë që u larguat në 1996 nga kjo
6 organizatë, kështu?

7 PË. Po.

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dua të tregoj një fragment, nga
9 libri "Flet Komandant Remi". Me ERN-në për gjuhën shqipe
10 SPOE00330195, shkojmë në faqen 330219. Anglishtja me numër ERN
11 SPOE00053263, faqja që na nevojitet është 53280.

12 PY. Në këtë pjesë thoni:

13 "Krahas rritjes së aktivitetit ushtarak, unë e rris edhe
14 aktivitetin tim publik në forumin rinor të LDK-së. Këtë e kam
15 parë të arsyeshme dhe të them të drejtën nuk kam guxuar të
16 shkëputem nga aktiviteti politik duke parë një rrezik."

17 Çfarë keni dashë të thoni kur keni thënë "Nuk kam guxuar
18 të shkëputem nga aktiviteti politik duke parë një rrezik"?

19 PË. LDK-ja ka qenë një subjekt politik me përmasa të mëdha,
20 dhe nuk ka pasë ndjekje të veçanta brenda LDK-së. Programi i
21 saj ka qenë paqësor, pasiv, dhe ne me lehtësi kemi ndërtue
22 shoqërinë mbrenda Lidhjes Demokratike të Kosovës.

23 PY. Prandaj -- po pse thoni që ishte e rrezikshme të
24 largoheshit nga LDK-ja?

25 PË. Nuk e di si mund të kuptohet kjo, por meqë isha në UÇK

1 anëtar i UÇK-së, duhej të isha diku në mesin e masave. E masat
2 ishin në Lidhjen Demokratike të Kosovës.

3 PY. A ishit dhe anëtar i LPK-së?

4 PË. Jo. Kam komunikuar me ta, i kam njohur, por s'kam qenë.

5 PY. Keni qenë i përfshirë në veprimtaritë e tyre?

6 PË. Po, i kam ndihmuar vazhdimisht edhe si nxënës edhe --

7 PY. Prej kur?

8 PË. Ishte në fund të viteve 1980. Kam qenë aktivist kur kam
9 qenë nxënës në shkollën e mesme.

10 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund të shkojmë në faqen 53338 në
11 anglisht dhe faqja 326, kalon te 2 në shqip.

12 PY. Këtu thoni:

13 "Në kontaktet me ilegale dhe në aktivitetet në të isha që
14 nga viti 1986. Kam bërë pra aktivitetet të pandërprerë me LPK-
15 në... derisa kam rënë në lidhje me UÇK-në. Gjegjësisht deri
16 kur Zahir Pajaziti e ka parë të udhës të më përfshinte në UÇK,
17 dhe të hapte dyert e fatit tim, nëse mund ta themi kështu."

18 Kështu është?

19 PË. Po.

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Përfunduar me këtë dokument.
21 Faleminderit.

22 PY. Keni dhënë dëshmi që deri në momentin e Rambujesë nuk e
23 dinit që ishte Azem Syla komandanti i përgjithshëm i UÇK-së,
24 kështu?

25 PË. Po.

1 PY. Dhe i kishit kërkuar Shtabit të Përgjithshëm të bënte të
2 ditur përbërjen e tij, kështu?

3 PË. Në një takim të gjithë komandantët e zonave e kemi bërë
4 bashkërisht këtë kërkesë.

5 PY. Ndërkohë, a kishit teoritë tuaja apo dyshimet tuaja mbase
6 se kush mund të ishte komandanti i përgjithshëm?

7 PË. Ka pasë përfolje, por nuk e kemi ditë saktë që -- cili
8 mund të jetë.

9 PY. Ju kush mendonit se mund të ishte?

10 PË. Në fakt unë s'kam menduar për askënd.

11 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do të donim të shihnim Pjesën 2,
12 faqet 24, kalojmë dhe te faqja 25 tek anglishtja. Dhe Pjesa 2,
13 faqja 29, kalojmë dhe te faqja 30 te shqipja.

14 PY. Ju kanë bërë pyetje:

15 "Po Rexhep Selimi çfarë pozite ka pasë?"

16 Ju përgjigjeni:

17 "Na kena dyshu që mundet me kenë edhe i pari. Ky është
18 opinionimi i imi, por s'e di. S'di me saktësi. Unë nganjëherë e
19 kam marrë që është komandant në Drenicë, po flas deri në 1998,
20 tetor. Nganjëherë m'u ka dukë sikur mundet me kanë edhe
21 komandant i përgjithshëm, por mbas tetorit 1998 ka marrë
22 pozitën e inspektorit të Shtabit të Përgjithshëm. Unë po ju
23 them shumë pozita që i kanë mbartë më vonë, as vetë s'e kanë
24 ditë këta që janë asi."

25 A është ky opinionimi juaj, është e vërtetë kjo që u tha,

1 ju keni menduar që mund të ketë qenë Rexhep Selimi?

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] Unë mendoj që është një
3 shtrembërim i përgjigjes, sepse këtu thuhet edhe personat
4 drejtues nuk kanë ditë çfarë pozicionesh kanë pasë asi.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Por unë e lexova dhe këtë fjali.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po atëherë ju keni edhe një
7 përmbledhje, sepse pastaj pyetja juaj është bazuar në një
8 shtrembërim të fragmentit përkatës.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk kemi
10 kundërshtime, mund të vazhdoni me pyetjen.

11 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

12 PY. A pasqyron kjo me saktësi mendimin tuaj, pra që ju
13 mendonit se komandant i përgjithshëm mund të ketë qenë Rexhep
14 Selimi në atë kohë?

15 PË. Përgjithësisht kanë qenë mendime të miat, ashtu si e
16 lexuat tekstin e përgjithshëm.

17 PY. Po ashtu dihej asokohe që kanë qenë dy
18 zëvendëskomandantë, kështu?

19 PË. Këto znj. Kryetare tek ma vonë mundena me thanë që po e
20 di.

21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do të doja të shihnim Pjesën 5,
22 faqja 13 tek anglishtja. Dhe Pjesa 5, faqja 14 tek shqipja.

23 PY. Pyetja ka qenë:

24 "Por Jakup Krasniqi çfarë roli kishte deri në fund të
25 tetorit?"

1 "PË. Zëvendës, është ditur, zëvendëskomandant.

2 "PY. I Shtabit të Përgjithshëm?

3 "PË. Po, ka qenë edhe një tjetër zëvendëskomandant i
4 Shtabi i Përgjithshëm, Sokol Bashota."

5 Kështu është, e saktë?

6 PË. Znj. Kryetare, Jakup Krasniqi gjithherë iu kemi drejtu
7 dhe e kemi njoftë si zëdhënës të UÇK-së. Ndikimet e mbas
8 pastajme, informatat e pastajme unë e kam ditë që ka qenë edhe
9 kështu si e kam thanë para Prokurorit. Për Sokol Bashotën e
10 kam kuptue edhe në një takim kur njëni nga avokatët flet për
11 të shtëna në atë takim. Edhe aty na është lexu së pari, por ai
12 nuk e ka vazhdu punën së paku në raport me ne, si zëvendës,
13 kurrë. Si zëvendëskomandant.

14 PY. Pavarësisht si u drejtoheshit personave apo çfarë roli
15 kishin, ju e dinit që të dy këta persona ishin caktuar si
16 zëvendëskomandantë. Kjo është e saktë?

17 PË. Po ju them, në fund të luftës dhe pas luftës e kemi
18 kuptu.

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Shkojmë te materiali me numër
20 SPOE00226367. Anglishtja me të njëjtin numër ERN, dhe
21 përfundon me ET.

22 PY. Mund të jetë një nga mbledhjet të cilës i jeni referuar
23 kur thatë që këtu e morëm vesh që ishte një personat bashkë me
24 Sokol Bashotën.

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Konkretisht duhet të shkojmë në

1 faqen 226398.

2 PY. Flet Ramush Haradinaj. Dhe te pika 4 thotë:

3 "Kalimi i Jakup Krasniqit nga zëdhënës në
4 zëvendëskomandant."

5 E shihni këtë fjalinë?

6 PË. Po ju thashë znj. Prokurore. Është fundi i luftës ky, dhe
7 është bë përpjekje për me ndërru emrat. Por unë asnjëherë
8 Jakup Krasniqin si zëvendës nuk e kam njoftë dhe nuk kam
9 komuniku me të si zëvendëskomandant.

10 Kalojmë në faqen 226403. Madje do kërkoja të shkonim një
11 faqe më sipër për të parë kush po flet me Sylejman Selimin.
12 Tani kthehemi tek faqja tjetër.

13 PY. Këtu thuhet:

14 "Jakup Krasniqi, me gjithë respektin që ka -- nuk e
15 meriton postin si zëvendëskomandant."

16 Është diskutuar kjo mes komandantëve të zonave, pra,
17 fakti që Jakup Krasniqi ishte zëvendëskomandant.

18 PË. Në veç këtu në këtë fletoren këtu, flet -- po folet për
19 përfundimet që ne komandantët e zonave i kemi ditë. Ne s'e
20 kemi njoftë si zëvendëskomandant, as në atë kohë. Tash s'po më
21 kujtohet më ky shkrim, por kështu kemi mendue ne komandantët e
22 zonave në atë kohë.

23 PY. Ditën e premtë diskutuat me një nga Avokatët Mbrojtës
24 marsin 1998 dhe thatë që është e rëndësishme që "të
25 udhëzoheshin personat të organizoheshit dhe t'i orientonin të

1 gjitha përpjekjet tona për të arritur synimin tonë që ishte
2 pavarësia e Kosovës.”

3 Pse ishte e rëndësishme që të ndërmerreshin këto hapa për
4 të udhëzuar personat që të organizoheshin?

5 PË. Në çdo kohë, znj. Prokurore, ka qenë e rëndësishme për ne
6 me i udhëzue njerëz, sepse ishim drejtues të Ushtrisë
7 Çlirimtare të Kosovës dhe vendit në përgjithësi.

8 PY. Ju, në fakt po përpiqeshit që të krijonit një ushtri
9 tamam, apo jo? Efektive?

10 PË. Po.

11 PY. Është e drejtë kur them që UÇK-ja nuk ishte shumë formale
12 si -- nuk ishte tamam si një ushtri e rregullt sa i takon
13 strukturës. Sepse keni thënë në dëshminë tuaj që nuk kishin
14 për shembull rangjet, gradat, kështu?

15 PË. Po.

16 PY. Dhe nuk kishte një ndarje të qartë përgjegjësish.
17 Personat jepnin kontributin e tyre me aq sa mundeshin, brenda
18 rolit që kishin dhe në fusha të tjera, kështu?

19 PË. Mund të pranohet kështu, po.

20 PY. Por sikurse thatë, kishte një strukturë udhëheqjeje,
21 saktë?

22 PË. Strukturë udhëheqjeje? Po mendoj ne që kishim marrë
23 përsipër, komandantët e zonave, Shtabin e Përgjithshëm, këtë e
24 mendoj.

25 PY. Brenda vetë strukturës së UÇK-së, në çfarë niveli ishin

1 zonat?

2 PË. Gjithherë përpjekje për organizim më të mirë znj.

3 Prokurore.

4 PY. Por në çfarë niveli të hierarkisë në zinxhirin e
5 hierarkisë të strukturës së UÇK-së, ku qëndronin zonat? Në
6 cilën pjesë të zinxhirit të hierarkisë?

7 PË. Zonat ishin organizimi më i lartë i strukturave në
8 Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

9 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do të doja të shihnim një
10 deklaratë të mëparshme. SPOE00119323 dhe 119331. Shqipja
11 SPOE00119334 deri në 9343.

12 PY. Në mes të paragrafit thoni diku:

13 "Shtabi i Përgjithshëm mori vendimin për qendrat e
14 ndalimit që besoj se ka qenë pjesë e strategjisë së UÇK-së.
15 Zona ishte niveli i dytë i zinxhirit të komandës. Unë isha
16 anëtar i komandës së Shtabit të Përgjithshëm për një kohë të
17 shkurtër në fund të shkurtit ose fillim të marsit 1999 dhe
18 isha përgjegjës për logjistikën, por gjërat ndryshuan dhe unë
19 iu ktheva luftimit."

20 Është e saktë kjo, që zona ishte niveli i dytë i
21 zinxhirit të komandës?

22 PË. Është Shtabi i Përgjithshëm, zona, dhe tani thashë veç
23 ashtu. Por është -- njësia e parë, është Shtabi i
24 Përgjithshëm.

25 PY. Gjatë intervistës që patët me ZPS-në në mënyrë të

1 vazhdueshme keni përdorur fjalën "urdhëresë". Kur flisni për
2 udhëzimet që merrnit nga Shtabi i Përgjithshëm, nuk ishin
3 rekomandime dhe nuk ishin kërkesa, siç propozuan Avokatët
4 Mbrojtës, por ishin urdhra, urdhëresë. Dhe do shohim një a dy
5 shembuj për këtë.

6 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Shkojmë tek Pjesa 3, faqja 2.

7 PY. Pyetja ka qenë kështu:

8 "A mund t'ju tregoj një dokument atëherë? Është një
9 dokument me datën 28 dhjetor 1998, me titullin "Ushtria
10 Çlirimtare e Kosovës, Drejtoria Operative e Shtabit të
11 Përgjithshëm" numër G-3/33-19. Desha të tregoj dhe shqipen.
12 Mund ta shihni dhe të më thoni nëse e njihni këtë?"

13 "PË. E di që kishte udhëzime ose urdhëresa
14 administrative që i kishte lëshuar Bislum Zyrapi. Ai kishte
15 autorizimin ta bënte, por nuk po më kujtohet kjo konkretisht
16 më në veçanti."

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund të shohim Pjesën 7, faqja 9,
18 kalon dhe tek faqja 10.

19 PY. Pyetja këtu ka qenë:

20 "Kush ishin komandantët e tjerë të zonave të pranishëm në
21 mbledhje me Shtabin e Përgjithshëm kur dhanë urdhrat për të
22 krijuar qendrat e ndalimit?"

23 "PË. Nuk më kujtohet. E di që kam thënë që kemi qenë të
24 gjithë atje, dhe ju thashë se i kemi marrë urdhrat prej tyre.
25 Në fund të mbledhjes, është e mundshme që ata të na kenë dhënë

1 dy-tri urdhra me një zarf, në fund të mbledhjes. Por nuk më
2 kujtohen hollësi të tjera për këtë. Ajo që është e rëndësishme
3 është që ky urdhër apo masë administrative ishte shtypur për
4 secilin prej nesh".

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, unë nuk dua të bëj një
6 kundërshtim të shtjelluar, por ky është nga shqetësimet që i
7 kemi ngritur më përpara, sa i takon aspekteve apo mënyrën si
8 është bërë intervista. Dhe besoj se pyetja është
9 sugjestionuese dhe në intervistë.

10 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Besoj se tha kundërshtimi juaj
11 është -- qëndron.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Megjithatë, unë po them që pyetja
13 është sugjestionuese.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
15 kundërshtimi.

16 Mund të vazhdoni Prokurore.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

18 PY. Dhe në ato rrethana, ju bëtë të pamundurën që të zbatonit
19 urdhrin, apo jo?

20 PË. Znj. Prokurore, sa për sqarim, urdhri, rekomandimi, apo
21 udhëzimi administrativ, duke pasë parasysh mundësitë e
22 zbatimit të atyne detyrave, pak ka rëndësi për mue si e them.
23 Domethënë, është detyrë që na është dhënë, por mundësitë kanë
24 qenë shumë të vogla për me i zbatue. Nga kjo unë kam luajtur me
25 terma, dhe nuk kam pasë ndonjë qëllim për të zbehë urdhënesën

1 administrative nga Shtabi.

2 PY. Dhe ju keni bërë të pamundurën për t'i zbatuar?

3 PË. Ka disa prej tyne që s'janë ardhë në konsideratë fare. Ka
4 shumë prej tyne.

5 PY. Kjo ka ndodhur pavarësisht nëse vinin nga personat që
6 ishin pjesë e përbërjes politike të UÇK-së, apo jo? Kështu?

7 PË. Rekomandimet apo urdhëresat, si të doni i quejmë, kanë
8 ardhur nga Shtabi i Përgjithshëm, nga Bislim Zyrapi, janë
9 shkruar. Për neve kanë qenë njisoj. Por shumë prej këtyne
10 dokumente unë po ju them s'kemi mujtë me i vu në jetë
11 asnjëherë.

12 PY. Ishin të njëjtat.

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Shohim SPOE00119028, faqja
14 119030. Shqipja është me numër reference SPOE00119028, me AT
15 në fund. E njëjta faqe.

16 PY. Kjo është deklarata që keni dhënë përpara gjykatës në
17 2013, aty keni përshkruar dhe UÇK-në:

18 "Një strukturë e komandë hierarkike ushtarake që operonte
19 bazuar në urdhrat e marra nga Drejtoria Politike, gjithmonë në
20 përputhje me konventat ndërkombëtare".

21 E pranoni këtë?

22 PË. Kjo ka qenë deklarata përfundimtare para gjykatës,
23 deklaratë jashtë betimit, dhe e kam thanë si të tillë, e kam
24 ndërtuar personalisht dhe e kam thanë.

25 PY. Tani, kur kishte pakënaqësi në mesin e komandantëve të

1 zonave rreth kohës së Rambujesë, nuk ishte struktura vetë
2 struktura e Shtabit të Përgjithshëm në përgjithësi që ishte
3 problemi. Apo jo? Vetëm ishin -- problemi ishin vetëm disa
4 emërime, specifike. A është kështu?

5 PË. Ka pasë probleme, kjo kohë na ka përcjellë me shumë
6 probleme, znj. Prokurore. Por problemet e emërimeve specifike
7 normalisht e di që kanë qenë shqetësim. Me thanë të drejtën,
8 për mue shqetësimi kryesor ishte në atë kohë pse Adem Demaçi
9 s'po mund të pajtonte me udhëheqjen që po shkonin në Rambuje.
10 Ky shqetësim më ka përcjellë. Të tjerët kanë qenë ma të vogla,
11 personale.

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të shkojmë tek dokumenti
13 SPOE00226328, versioni në anglisht ka të njëjtin numër, me
14 shtesën ET. Të shkojmë tek faqja 226357.

15 PY. A e shikoni datën edhe vendin e shënumë në krye të faqes?
16 Dhe nëse po, ju lutem lexojeni me zë datën edhe vendin.

17 PË. 13.2.1999, Drenicë.

18 PY. Këtu diskutohen pozitat e komandantëve të zonave.

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të kalojmë tek faqja tjetër.

20 PY. E shikoni emrin tuaj aty në faqe, dhe aty thuhet:

21 "Shtabi i Përgjithshëm nuk kundërshtohet në përgjithësi.
22 Vetëm disa persona kundërshtohen."

23 Kjo ka qenë qëndrimi juaj në atë kohë, apo jo? Nuk
24 kontestohet.

25 PË. Nuk më kujtohen, znj. Prokurore. Me siguri kështu duhet

1 të jetë. Qenka në procesverbal si mos me --

2 PY. Dhe në pikën në vazhdim thuhet:

3 "Nuk besoj që asnjë nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së
4 nuk ka përdorë SHIK-un... për të ushtru presion, trysni".

5 Çfarë ju ka shty të mendoni se shërbimi i zbulimit është
6 përdorë për të ushtru presion?

7 Z. EMMERSON: [Përkthim] Përpara se të përgjigjet
8 dëshmitari në këtë pyetje, a mund ta kemi të qartë se për
9 cilat shërbime të zbulimit apo të inteligjencës bëhet fjalë?
10 Se kjo mund të jetë e rëndësishme.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Besoj që
12 Prokuroria tha SHIK.

13 Z. EMMERSON: [Përkthim] SHIK-u është shkurtesa për
14 shërbimin e zbulimit shqiptar.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni me
16 sqarimin, znj. Prokurore.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dëshmitar, a mund t'i përgjigjeni
18 pyetjes që jua bëmë në fillim? Çfarë ju ka shty të mendoni se
19 shërbimet e zbulimit përdoreshin për të ushtru presion?

20 PË. Nuk mundem me thanë asgja znj. Prokurore. Unë, në atë
21 kohë të vetmin qëllim, prioritet, e kam pasë që Adem Demaçi të
22 shkojë në Rambuje. Nuk më kujtohet që kam pasë prioritete për
23 dikë të veçantë.

24 PY. Atëherë, supozoj që gjithashtu nuk ju kujtohet se për
25 cilin shërbim të zbulimit e kishit fjalën, ose për cilin

1 person në Shtabi i Përgjithshëm keni besu që ka përdorë këto
2 shërbime për këtë qëllim. Edhe kjo nuk ju kujtohet atëherë?
3 PË. Nuk më kujtohet fare që është diskutu për shërbime këtu.
4 Por, unë kam sido që të jetë s'po shoh gjë të keqe, s'e di çka
5 kam mujtë me mendue në atë kohë.

6 PY. Avokati i Mbrojtjes, të premtën ju bëri disa pyetje në
7 lidhje me komandant Drinin në takime, dhe ju na treguat se
8 komanda e zonës së Pashtrikut ndryshohej shpesh. Kjo është
9 thënë në faqen T5605 të transkriptit. A ju kujtohet
10 konkretisht se në cilin takim të parë mori pjesë komandant
11 Drini?

12 PË. Jo, znj. Prokurore. Vetëm nëse më tregoni dokumentet që
13 ai ka marrë pjesë, mund të më kujtohet, por pa diçka të
14 shkruar nuk më kujtohet. Por e di se ai ka marrë pjesë në
15 mbledhje të Shtabit.

16 PY. Më herët sot në faqet 8 dhe 9 të transkriptit të
17 përkohshëm, ju i konfirmuat Avokatit të Mbrojtjes se të gjithë
18 anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm me përjashtim të Jakup
19 Krasniqit dhe Ramë Bujës, kanë qëndru jashtë vendit. Por kjo
20 nuk është plotësisht e saktë, apo jo? Për shembull, Lahi
21 Brahimaj, ai a ka qenë jashtë vendit?

22 PË. Jo, edhe ai qenka. Edhe ai ka qenë anëtar i Shtabit. Ai
23 ka qenë ndërkohë, ka --

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] Përsëri u ngrita në këmbë për të
25 kërkuar sqarim. Sepse lë njëfarë përshtypje sugjestionuese

1 pyetja. Z. Lahi Brahimaj ishte komandant i zonës, jo vetëm
2 anëtar i Shtabit të Përgjithshëm dhe ky është fakti sepse ai
3 qëndroi në vend.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtimi
5 rrëzohet.

6 Mund të vazhdoni znj. Prokurore.

7 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dëshmitari e konfirmoi që ai në
8 fakt ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm dhe ju ndoshta e
9 ngatërroni periudhën kohore gjatë të cilës ka qenë komandant i
10 zonës.

11 PY. Do të vazhdojmë dëshmitar. Rexhep Selimi, ai a ishte
12 jashtë vendit apo ishte në Kosovë?

13 PË. Ka pasë kohë që ka qenë jashtë, por kryesisht Rexhep
14 Selimi ka qenë brenda vendit.

15 PY. Fatmir Limaj, a ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm
16 dhe ai a ishte në Kosovë?

17 PË. Nuk më kujtohet saktësisht dhe vonë është ardhë Fatmir
18 Limaj në Shtab të Përgjithshëm, dhe ai nga koha kur e njoh
19 unë, gjatë bombardimeve më duket se ka udhëtue jashtë vendit.
20 Ka qenë në shtetin shqiptar.

21 PY. Por mund të vijmë në përfundim se duhet të korrigjohet
22 ajo deklaratë që dhatë më përpara, domethënë nuk është e saktë
23 që të gjithë anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm kanë qenë
24 jashtë vendit.

25 PË. Unë edhe e kam thanë tashmë, ta merrni si të doni, por

1 unë po them kohë pas kohe kanë qenë, kanë mujtë me qenë edhe
2 të tjerët. Por ka shumë si Adem Grabovci, Hashim Thaçi, Kadri
3 Veseli, Xhavit Haliti, Azem Syla, më shumë janë jashtë vendit
4 se sa mbrenda. Tash s'po më kujtohen edhe të tjerë.
5 PY. Avokati i Mbrojtjes ju pyeti në qoftë se kishte pjesëtarë
6 të FARK-ut që kanë qenë të pranishëm në zonën e Llapit. Këtë
7 pyetje ua bëni të premtën, dhe kjo është në faqen e
8 transkriptit 5725. A keni pasë raste kur kanë ardhë njerëz,
9 janë përpjekë me iu bashku UÇK-së në zonën e Llapit dhe këta
10 njerëz janë të caktumë prej ministrisë së mbrojtjes të
11 qeverisë në ekzil?
12 PË. Po, ka qenë, ka pasë raste. Por ata që të nesërmen kurrë
13 më s'kanë ditë gjë për FARK-un, s'kanë bisedu për FARK-un. Ata
14 -- kanë hy mbrenda UÇK-së dhe kanë harruar FARK-un. S'ka pasë
15 ambient të FARK-ut në regjionin ku isha unë.
16 PY. Unë do t'jua përkujtoj një rast konkret.
17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Duhet të shkojmë në seancë
18 private për një moment të shkurtër, të nderuar Gjykatës.
19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në
20 seancë private.
21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Në janar të 1999 --
22 [Seancë private]
23 [Seancë private teksti i fshirë]
24
25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20 [Seancë e hapur]

21 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni,

23 znj. Lawson.

24 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

25 PY. Sot në mëngjes Avokatja e z. Krasniqi ju bëni disa pyetje

1 në lidhje me një takim në të cilin Shtabi i Përgjithshëm
2 urdhëroi ndalimin, arrestimin, e bashkëpunëtorëve dhe ju thatë
3 që nuk ju kujtohej në qoftë se ishte mbajtur një mbledhje e
4 tillë.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Unë tani do t'ju çoj te deklarata
6 që keni dhënë më parë. Është Pjesa 3, faqja 25.

7 PY. Pyetja ishte:

8 "Ju dëgjoj, por ju kërkoj të më jepni përgjigje të
9 drejtpërdrejtë, që është: Çfarë ishte ajo që Shtabi i
10 Përgjithshëm në atë mbledhje e në mbledhje të tjera, i
11 urdhëroi komandantët e zonave?

12 "Apo politika, se çfarë politike duhej të ushtrohej në
13 lidhje me bashkëpunëtorët? Çfarë ju tha komandantëve të zonave
14 që të bënin?

15 "PË. Ne kishim urdhër që t'i ndalonim, dhe t'i çonim tek
16 gjykata ushtarake, mirëpo në atë kohë nuk kishte një gjykatë
17 ushtarake.

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dhe te Pjesa 3, faqja 27 thuhet -
19 - më falni, Pjesa 3, faqja 29.

20 "PY. Në rregull. Domethënë Shtabi i Përgjithshëm i
21 urdhëroi komandantët e zonave që të ngrinin këto qendrat e
22 ndalimit."

23 Përgjigje:

24 "Kishte një urdhër administrativ që e mora. E di që ka
25 pasë."

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Znj. Kryetare [sipas përkthimit],
2 dëshiroj të bëj të qartë kundërshtimin tim. Në qoftë se bëhet
3 fjalë për çështje fajësimi, nuk kam kundërshtime. Në qoftë se
4 është për vërtetësinë e çështjeve të cilat u ngritën, atëherë
5 unë paraqes një kundërshtim. Mungon baza, faleminderit.

6 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, është për të
7 dyja aspektet, e qartësisht që kishte një bazë kur dha dëshmi
8 më herët.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, është për
10 të dyja. Kundërshtimi rrëzohet. Atëherë, mund të flasim që
11 është për vërtetësi ose për fajësim.

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

13 PY. A ju rifreskon kjo kujtesën që është mbajtur një mbledhje
14 dhe se është dhënë një urdhër atje për të ndaluar
15 bashkëpunëtorët?

16 PË. Qëndroj pas deklaratës sime të dhënë para Prokurorit, por
17 duhet të lexohet në tërësi. Edhe shihen hamendësimet e mia
18 edhe ndaj këto.

19 PY. Absolutisht. Doni që t'ua lexoj nga citimi i fundit? Ku
20 thoni:

21 "Ka pasur një urdhëresë administrative. E di që ka."

22 Dhe pastaj bëhet një pyetje. Doni që të vazhdoj? Apo po i
23 referoheni faktit që deklarata duhet marrë në tërësinë e vet?

24 PË. Po.

25 PY. Deklarata pra.

1 PË. Deklarata, po.

2 PY. Të premtën, Avokati i Mbrojtjes ju tregoi Komunikatën 54
3 dhe ju pyeti në qoftë se ka lidhje mes asaj komunikate
4 konkrete dhe ndalimeve në regjionin tuaj, në zonën tuaj. Dhe
5 kjo është thënë në transkript në faqen 39 dhe 40. Dhe ju i
6 jeni përgjigjur "jo". Atëherë, bazuar në cilin autoritet u
7 ngritën qendrat e ndalimit në zonën e Llapit?

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Do ta kundërshtoj. Është jashtë
9 kuadrit të kundërpvetjeve të mia. Ajo tregoi një komunikatë.
10 Iu përgjigja me një komunikatë. Kjo ishte komunikata për të
11 përcaktuar faktin që kishte qendra të ndalimit. Kjo nuk është
12 pjesë e kundërpvetjeve sepse në qoftë se do ta lejoni këtë
13 atëherë do të bëj edhe unë pyetje shtesë.

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nuk kam kundërshtime në qoftë se
15 Avokati Mbrojtës dëshiroj të bëjë pyetje të tjera si
16 kundërpvetje, mund ta bëjë lirisht.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe unë mbaj
18 mend që u diskutua kjo gjë, kështu që pyetja do të lejohet.

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

20 PY. Po ju pyesja, mbi cilin autoritet u mbështetët për
21 krijimin e qendrave të ndalimit në zonën e Llapit?

22 PË. Ne edhe përpara kësaj deklaratës së Shtabit të
23 Përgjithshëm, kemi pasë -- shtëpi ndalimi në zonën tonë. Ishte
24 nën autoritetin e shtabit që po udhëheqja unë.

25 PY. Saktë. Dhe çfarë përdorët si bazë, ose më saktë sipas

1 jush, kush ua dha lejen, çfarë jua dha lejen për të trajtuar
2 personat në atë mënyrë duke i ndaluar ata?

3 PË. Thjesht jemi gjindë para nevojave, dhe kemi vendosë mbi
4 arsyet ushtarake.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dua t'ju tregoj disa deklaratata të
6 mëhershme.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] E para, Pjesa 3, faqja 19
9 anglishtja. Dhe Pjesa 3, faqja 25 shqip.

10 PY. Pyetja ka qenë:

11 "Kur vendosi Shtabi i Përgjithshëm që duhej të kishte një
12 praktikë për ndalimin e bashkëpunëtorëve?

13 Përgjigjja juaj:

14 "Kishte komunikata ku jepeshin paralajmërime edhe pa --
15 fillu lufta. E ato komunikatat i kemi shfrytëzu për
16 riorganizime dhe organizimet. Nga sa më kujtohet nga
17 komunikatat e para u është tërheqë vërejtja bashkëpunëtorëve.

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Paragrafi tjetër që dua të
19 shohim. Në Pjesën 7, faqja 6, edhe anglishtja edhe shqipja.

20 PY. Këtu thoni:

21 "Z. Prokuror, kanë qenë komunikatat edhe më herët. Edhe
22 komunikatat kanë leju që me u marrë me njerëzit që e pengojnë
23 misionin e UÇK-së. Lirimi, dhënia e urdhrit bëhet nevojë në
24 një kohë të caktueme pas ofensivave të shtatorit. Mirëpo,
25 vetëm mos më kapni për kohën cili është momenti."

1 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Shohim dhe një tjetër material,
2 ju lutem. Që është pjesa 8, faqja 4, edhe anglishtja edhe
3 shqipja.

4 PY. Pyetja ka qenë:

5 "Ky vendi i ndalimit si është ngritur ose si është
6 vendosur qendra e ndalimit atje? Apo kush e ka urdhëruar?

7 "PË. Unë ju thashë, ka pasë nga Shtabi i Përgjithshëm,
8 ju thashë që ka pasë edhe komunikata, por ne jemi gjindë para
9 nevojës dhe i kemi kriju ato. Nevoja na ka shti me i kriju. As
10 në mendje s'e kemi pasë më parë, por ne nuk kemi dashtë të
11 dëmtohem nga ato forma të liga.

12 Këto fragmentet që ju lexova, paragrafët që ju lexova,
13 janë të sakta apo jo?

14 PË. I pranoj, znj. Prokurore, dhe janë pjesë e kësaj që
15 thashë edhe sot. Komunikata është pjesë e arsyes ushtarake.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet të
17 bëjmë pushimin e paradites.

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kam dhe katër pyetje për të
19 mbaruar pyetjet e mia.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Nuk ka përkthim]

21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

22 PY. Kur e diskutuat gjuhën e komunikatave -- me Avokatin
23 Mbrojtës, ju pranuat që sipas të drejtës jugosllave, dikush
24 mund të dënohej dhe me vdekje për bashkëpunim dhe spiunazh në
25 kohë lufte. Ju kujtohet ky bisedim apo kjo pyetje-përgjigje me

1 Avokatin Mbrojtës?

2 PË. Po, më kujtohet që folëm për këtë punë.

3 PY. Ndonjë nga personat që është akuzuar për bashkëpunim në
4 zonën e Llapit, a është çuar para një gjyqi dhe a është
5 dënuar?

6 PË. Jo.

7 PY. Ndonjë person që është akuzuar për bashkëpunim, në
8 komunikatat e Shtabit të Përgjithshëm, a është gjykuar dhe a
9 është dënuar?

10 PË. Komunikatat s'kanë folë specifikisht për person, për
11 individ.

12 PY. Personat thjesht janë mbajtur të ndaluar ose janë vrarë,
13 kështu?

14 PË. Jo, znj. Prokurore, nuk ka persona të mbajtur të vrarë.

15 PY. Z. Mustafa, faleminderit për kohën tuaj.

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kam
17 pyetje shtesë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Kam dhe unë nevojë për pesë,
20 dhjetë minuta, por e di që kemi nevojë edhe për pushimin.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

22 Z. ROBERTS: [Përkthim] Kam nevojë dhe unë për disa minuta
23 për të bërë pyetje, në qoftë se është e mundur.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

25 [Përkthim] Z. Dëshmitar, do të bëjmë gjysmë ore pushim.

1 Do të kthehemi në orën 10.35 -- atëherë, dhe njëherë, në
2 11.35, më falni. Do t'ju shoqërojnë jashtë sallës së gjyqit
3 tani.

4 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kthehemi në
6 11.30.

7 --- Pauza fillon në orën 11.04

8 --- Seanca rifillon në orën 11.33

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, z.
10 Emmerson.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua t'ju
12 informoj, më jepni një çast ju lutem.

13 Edhe unë kam një aspekt që dua ta shqyrtoj që buron nga
14 pyetjet e znj. Lawson. Janë më shumë sqarime për disa nga
15 pyetjet. Nuk do më marrë shumë kohë, por është shumë e
16 rëndësishme. Thjesht jua thashë këtë që të më keni parasysh
17 kur të na jepni fjalën.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Meqë kam qenë
19 kaq bujar, sot sigurisht që do jem bujar edhe për ju.

20 Vazhdoni, z. Misetic.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Duhet të vijë një herë dëshmitari.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju duhet
23 dëshmitari? Meqë ju duhet, thirrreni.

24 Ndonjëherë nëpër se ka gjyqe -- që s'ka dhe dëshmitarë,
25 kështu që nuk është kaq shumë për t'u habitur. Sidomos, në

1 qoftë se pyetjet shkojnë siç duhet.

2 [Dëshmitari vijon dëshminë]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
4 uleni, Dëshmitar.

5 Dëshmitar, ekipi i Mbrojtjes, tre nga ekipet e Mbrojtjes,
6 Avokatët Mbrojtës kanë disa pyetje të tjera sqaruese që
7 burojnë nga pyetjet që ju parashtroj pak më herët znj. Lawson.

8 Fjalën e ka z. Misetiç.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

10 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetiç:

11 Z. MISETIC: [Përkthim]

12 PY. Z. Mustafa kam disa pyetje të shkurtra për ju.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Do kërkoja që të shfaqej në ekran
14 SPOE00226367 deri në SPOE00226433-ET dhe shqipja është
15 SPOE00226367 deri në SPOE00226433. Do kërkoj dhe faqen
16 konkrete që më nevojitet SPOE00226403

17 PY. Z. Mustafa, do nxjerrim edhe një herë shënimet nga
18 mbledhja me komandantët e zonave që u mbajt më 6 shkurt. Dhe
19 do të trajtoj disa nga pyetjet që u bënë në fillim të faqes 24
20 të transkriptit të sotëm, rreshti 23. Dhe atje ju thanë që
21 komandantët e zona nuk është se nuk ishin të kënaqur me
22 strukturën, por me disa nga emërimet konkrete. Dhe për këtë do
23 ju bëj një pyetje sqaruese.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Do ju lutesha të shkonim një faqe
25 më lart për të parë folësin që është Sylejman Selimi.

1 PY. E shihni që po flet Sylejman Selimi?

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë tani tek faqja origjinale
3 që më nevojitej.

4 PY. Ua tregon këtë dokument më herët sot:

5 "Jakup Krasniqin me gjithë respektin që ka nuk është
6 personi i duhur për postin e zëvendëskomandantit".

7 Pra, një nga personat ka shprehur pakënaqësi për faktin që
8 është emëruar Jakup Krasniqi, saktë?

9 PË. Sipas këtij dokumenti, po.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër.

11 PY. Në fund fare thuhet:

12 "Në qoftë se Sokol Bashota dhe Jakupi mbeten në këto
13 poste unë nuk i përgjigjem më Shtabit të Përgjithshëm ose nuk
14 i raportojuj më Shtabit të Përgjithshëm".

15 E shihni këtë?

16 PË. Po unë e shoh, z. Avokat, këtu. Po e shoh këtu.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund ta ulni poshtë shqipen, ju
18 lutem? Po.

19 PY. Pra, Sylejman Selimi, Sylejman Selimi, qartazi nuk ishte
20 i kënaqur as me Sokol Bashotën edhe as Jakup Krasniqin, saktë?

21 PË. Kështu po shkruan këtu.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër.

23 PY. Sami Lushtaku dhe pastaj ju personalisht e për këtë dua
24 të më komentoni. Sami Lushtaku thuhet se ka thënë:

25 "Rexhep Selimi, Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli janë

1 përgjegjës për këtë situatën ku jemi ne për momentin".

2 Pastaj ju keni thënë:

3 "Këta persona i kanë zhgënjyer bashkëluftëtarët e tyre".

4 Çfarë keni dash të thoni ju që kur jeni shprehur se
5 Rexhep Selimi, Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli i kanë zhgënjyer
6 bashkëluftëtarët e lartë, të vjetër, më fal, të luftës?

7 PË. Nuk, nuk e di tash çfarë kam mendue, por me siguri kam
8 menue se kanë ik nga komandantët që merreshin me operacione.
9 Komandantët në terren. Veç po hamendësoj tani. Nuk jam i
10 sigurt çfarë kam mendu atëherë.

11 PY. Po a është e drejtë të themi që disa nga personat për të
12 cilët ishin të pakënaqur komandantët e zonave ishin,
13 përfshinin Jakup Krasniqin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin edhe
14 Hashim Thaçin. Është e drejtë ta themi këtë?

15 PË. Në bazë të kësaj qa po shkruan këtu është e drejtë.

16 PY. Faleminderit.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] A mund të shohim edhe faqen
18 tjetër për të bërë më të qartë kontekstin e kësaj deklarate?

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo nuk kam nevojë. Nuk kam pse
20 t'ia tregoj faqen tjetër. Faleminderit.

21 Dua t'ju tregoj, po ashtu, një përgjim ku ju po flisni
22 për disa nga këta zotni. Edhe për këtë do kërkoja që të
23 shfaqej -- Kalojmë në seancë private ju lutem, për dëshmi --
24 pyetjet?

25 [Seancë private]

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10 [Seancë e hapur]

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

12 Z. MISETIC: [Përkthim]

13 PY. Sa u takon komunikatave, asnjëherë s'ju ka treguar

14 Prokuroria ndonjë komunikatë konkrete apo të veçantë që të

15 përcillte ndonjë mesazh për ndalimet, përveç Komunikatës 54,

16 kështu?

17 PË. Nuk më kujtohet që më ka treguar asnjë komunikatë.

18 PY. Pra, në gjatë intervistave me Prokurorinë dhe pyetje që

19 bëri Prokuroria, edhe pyetjeve shtesë që ju bëri më pas, ju ka

20 treguar vetëm një komunikatë dhe ju ka pyetur nëse ajo

21 komunikatë përmbante ndonjë gjë aty lidhur me ndalimin. Është

22 e drejtë?

23 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jo, unë nuk ia bëra këtë pyetje.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] A mund të përgjigjem?

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni

1 çaktivizuar].

2 Z. Misetiç, keni dalë përtej kuadrit të diskutimit tuaj
3 fillestar, kështu që do doja që të shihnim konkretisht pjesën
4 e transkriptit.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Në qoftë se nuk e gjen dot
6 referencën, mund të më korrigjoni. Por pyetja ime lidhur me
7 Komunikatën 54 nuk ishte në mënyrën se si e shprehu Avokati.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mendoj se ka
9 të drejtë.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk po flas për Komunikatën 54,
11 por ajo pa deklaratat e mëparshme dhe i përmendi komunikatën
12 dhe mënyrën se si komunikatat përcillnin mesazhe që nxisni
13 praktika ndalimi. Unë e pashë, e thashë në formulim më të
14 përgjithshëm dhe unë po e them, mund ta bëj më qartë për atë
15 dhe për Prokurorinë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kështu
17 bëjeni, ju lutem.

18 Z. MISETIC: [Përkthim]

19 PY. Z. Mustafa, ju nuk ju kanë treguar asnjë komunikatë për
20 të kuptuar për çfarë komunikatash flisnit ju në intervistën e
21 Prokurorisë e këto komunikata të përmendnin praktikat për
22 ndalimin e personave, saktë?

23 PË. Po.

24 PY. Ju kujtohet ndonjë komunikatë e veçantë ju, tani që jeni
25 këtu, përveç Komunikatës 54 që e trajtuam. Pra, këto

1 komunikata ju kujtohen komunikata ku ju thoni se duhet të
2 ndalonit personat në zonën tuaj dhe e kam fjalën ndonjë
3 komunikatë e veçantë?

4 PË. Jo, s'më kujtohet.

5 PY. Ju pyetëm, po ashtu ju lexuam pjesë të intervistave me
6 Prokurorinë pjesë lidhur me urdhëresat e Shtabit të
7 Përgjithshëm sa i takon ndalimeve. Dhe sikurse e bëra me dije
8 dhe gjatë kundërpjetjeve ju thatë që i pranishëm gjatë këtyre
9 mbledhjeve ka qenë edhe komandant Drini dhe diçka të tillë e
10 keni thënë dhe në intervistat me Prokurorinë. Më konkretisht
11 është materiali numër 082894, Pjesa 7, faqja 9 dhe 10. Ky
12 dokument.

13 Pra, me sa ju kujtohet ju, në mbledhje të tilla të
14 Shtabit të Përgjithshëm dhe ku jepeshin urdhra për ndalimin,
15 keni thënë që ka qenë i pranishëm komandant Drini. Këtë e keni
16 thënë intervistës, në intervistë me Prokurorinë?

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës, nuk ka
18 thënë kështu dëshmitari në intervistat e Prokurorisë, kështu
19 që doja që të na japi referenca Avokati mbrojtës.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ta shohim
21 referencën që të shohim fjalët, fjalë për fjalë si e ka thënë
22 dëshmitari.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, mund ta vendosim në ekran në
24 qoftë se ju shërben më shumë. Atëherë kemi materialin me numër
25 082894, transkripti AT, Pjesa 7, faqja 11, rreshtat 17 deri në

1 25.

2 PY. Pyetjen ua bënë kështu:

3 "Kush ishin komandantë të tjerë të zonave të pranishëm në
4 mbledhje kur jepesh urdhrat për të krijuar shtëpitë e
5 ndalimit?"

6 "PË. Nuk e di. E di që kemi thënë që kemi qenë të gjithë
7 atje dhe të thashë si i kemi marrë urdhrat prej tyre, por në
8 fund të takimit është e mundur që ata të na kanë dhënë dy ose
9 tre urdhra në një zarf, në fund të mbledhjes. Por nuk më
10 kujtohen më shumë hollësi për këtë. Ajo që është e rëndësishme
11 është që urdhri ose masa administrative ishte shtypur për
12 secilin nga ne".

13 "PY. Por ju e dini z. Mustafa, kush ishin komandantët e
14 tjerë të zonave në atë kohë apo jo?"

15 "PË. Po"- thoni ju -.

16 "PY. "Dhe mund të na i rendisni të gjitha?"

17 "PË. - ju thoni: "Sa i takon pjesës konkrete nuk duhet
18 përmend asnjë fjalë për fjalë, sepse të gjithë e dinin se kush
19 ishin komandantët e zonave".

20 "PY. Mirë, a mund të na thoni se kush kanë qenë të
21 pranishëm të paktën në mbledhje".

22 Prapë, ju thoni:

23 "Ju lutem, na thoni kush ka qenë komandantët e zonave në
24 atë kohë?"

25 "PË. - Jeni përgjigjur: "Po i njihja. Janë miqtë e mi.

1 Janë krahu im i djathtë dhe i majtë. Zona e 4-t, që është
2 krahu im, dora ime e djathtë është Rrahman Rama, zona e
3 Shalës. Komandanti i zonës së Karadakut, i Pashtrikut ka qenë
4 komandant Drini, zona e Dukagjinit Ramush Haradinaj, zona e
5 Drenicës ka ndërrue emrat edhe kohë pas kohe. Mbjaj mend që ka
6 qenë Sylejman Selimi dhe pastaj Sami Lushtaku”.

7 Pra, mendoj që pyetja ime ishte e drejtë.

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, por jo pyetjen siç jua bëtë
9 ju.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtimi është i pabazë.

11 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kundërshtimi është i bazuar.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

13 Vazhdoni.

14 Z. MISETIC: [Përkthim]

15 PY. Pra, kur ju pyeti Prokurorja, kush ka qenë konkretisht në
16 këto takime ku janë diskutuar ndalimet, ju thatë që i
17 pranishëm ka qenë komandant Drini.

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] E kundërshtoj. Nuk është e saktë.

19 Pyetja ka qenë, kush kanë qenë komandantët e zonave në atë
20 kohë. Dhe dëshmitari është përgjigjur në intervistë që nuk i
21 kujtohen.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po tha që nuk
23 i kujtohen.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Po atë e kanë nxitur që të
25 përgjigjet dhe ky është qëllimi i gjithë bisedës.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë,
2 kundërshtimi rrëzohet.

3 Z. MISETIC: [Përkthim]

4 PY. Edhe një herë z. Mustafa. Pyetja ime ishte kjo: Kur i
5 dhatë dëshmi Prokurorisë, kur ju pyeti kush ka qenë i
6 pranishëm në mbledhjet ku është diskutuar, kur janë diskutuar
7 ndalimet ju keni thënë që komandant Drini ka qenë i pranishëm,
8 kështu?

9 PË. Po.

10 PY. Kurse unë e përmenda gjatë kundërpyetjeve të mia,
11 Prokuroria pretendon dhe pajtohem që komandant Drini u bë
12 komandant vetëm më 16 dhjetor 1998. Dhe ju u pajtuat më këtë
13 kur ju bërë unë pyetjet e mia. A ju kujtohet?

14 PË. Nuk po e di unë saktësisht data kur ka qenë komandant,
15 kur janë emëru nuk e di, por komandant Drini njihet komandanti
16 më afatgjatë i zonës së Pashtrikut

17 PY. Dua ju bëj një pyetje tjetër që jua bëra dhe kur bëra
18 kundërpyetjet në fillim, por do t'jua bëj se është me rëndësi,
19 sepse s'po e bën Prokurorja. Më gjegjësisht, kush mund t'i
20 ketë lëshuar urdhëresat apo udhëzimet apo si doni që t'i quani
21 ju, për ndalimin në mbledhjen e Shtabit të Përgjithshëm?

22 PË. Nuk e di.

23 PY. A ju kujtohet që kur bëra kundërpyetjet ju tregova dy
24 urdhëresa të nënshkruara nga Bislum Zyrapi që lidheshin me
25 çështjen e ndalimin të civilëve?

1 PË. Të gjitha, neve urdhëresat e shkruara na u ka përcjellë
2 nga Shtabi i Përgjithshëm, në emër të Shtabit të Përgjithshëm
3 nga Bislum Zyrapi; ajo dihet tanimë.

4 PY. Mbledhjet ku mund të ketë qenë i pranishëm komandant
5 Drini, edhe Bislum Zyrapi, kjo s'mund të ketë ndodhur para
6 dhjetorit të '98-s. E pranoni këtë?

7 PË. Ashtu besoj.

8 PY. Shtëpia e ndalimit në Llapashticë u krijua në nëntor ose
9 në fund të tetorit, saktë?

10 PË. Nuk ishte e krijuar. Kjo ishte vetëm e bartur nga një
11 vend në një vend tjetër. Ne kishim krijuar edhe gjatë gushtit
12 '98. E njëjta është bart varësisht ku jemi bart ne.

13 PY. Po u mbart në Llapashticë në çfarë kohe, në çfarë
14 periudhe?

15 PË. Mund të jetë nëntor, fillimi i nëntorit. S'po di, s'jam i
16 sigurt.

17 PY. Dhe një pyetje të fundit që jua bënë lidhje me argumentin
18 përmbyllës.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Është dokumenti SPOE00119028 deri
20 në SPOE00119032-ET [sipas përkthimit]. Faqja që na duhet është
21 SPOE00119030, kurse versioni në anglisht SPOE00119028 deri në
22 9032, faqja 9030.

23 PY. Ju bënë pyetjen në lidhje me pikën e katërt, ta quajë
24 ashtu, është diku nga fundi i faqes.

25 "Një strukturë dhe komandë hierarkike që operonte bazuar

1 në urdhrat e marra nga Drejtoria Politike, gjithmonë në
2 përputhje me konventat ndërkombëtare”.

3 Besoj që një nga gjërat që thatë në përgjigje të pyetjes
4 së Prokurorisë që i dhatë ju ishte se ju e dini që nuk ishit
5 nën betim apo jo?

6 PË. Po. Po.

7 PY. Dhe kur e përmendët “Drejtorinë Politike” si term, si
8 fjalë aty e keni përfshi edhe Adem Demaçin, domethënë, brenda
9 asaj strukture, të Drejtorisë Politike, a është kjo e saktë?

10 PË. Sigurisht. Sigurisht. [e pakuptueshme].

11 PY. Dhe besoj se keni thënë shumë herë deri tani, por ia vlen
12 që të konfirmohet edhe një herë, ju keni qenë personalisht
13 shumë i afërt me Adem Demaçin, a është kjo e saktë?

14 PË. E saktë.

15 PY. Në rregull. A të kujtohet të kesh marrë ndonjë urdher
16 konkret prej Drejtorisë Politike?

17 PË. Jo.

18 PY. Faleminderit z. Mustafa që iu përgjigjet pyetjeve të mia.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Këtu përfundoj pyetjet e mia
20 plotësuese.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emerson A
22 keni pyetje?

23 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Emerson:

24 Z. EMMERSON: [Përkthim]

25 PY. Dëshmitar, do t’ju bëj një apo dy pyetje në lidhje me një

1 dokument për të cilët ju bëri pyetje, Prokurorja, znj. Lawson,
2 gjatë pyetjeve shtesë që jua bëri.

3 Z. EMMERSON: [Përkthim] A mund ta vendosim në ekran
4 dokumentin me numër SPOE00226328 deri në faqen SPOE00226365-
5 ET, pra, janë versionet në anglisht dhe në shqip. Dhe faqja që
6 më intereson mua është me numër SPOE00226358.
7 PY. Patë shënime të ndryshme nga dy takime të ndryshme dhe
8 dua të jem i qartë rreth kronologjisë së këtyre takimeve.
9 Njoni takim u mbajt me datën 6 shkurt dhe z. Misetić ju bëri
10 pyetje në lidhje me këtë takim dhe pastaj mbledhja e dytë që u
11 mbajt gjatë periudhës së negociatave të Rambujesë që është me
12 13 shkurt dhe është ajo që na thatë që filloi me shtënat e
13 armëve prej Ramush Haradinajt.

14 Dhe pjesa që jua lexoi Prokurorja ishte prej mbledhjes së
15 dytë. Pra, jemi në datën 13 shkurt në atë mbledhje. Në një
16 fazë të mavonshme të fazës së parë të Rambujesë. Në qoftë se e
17 shikoni shënimin me emrin tuaj aty është brenda një konteksti,
18 të një diskutimi që do ta shohim tani për një minutë flitet
19 për disa ndryshime në Shtabin e Përgjithshëm sidomos në
20 përbëmjen e delegacionit të Rambujesë, por edhe për
21 përgjegjësinë e përgjithshme. Dhe aty shënohet se keni thënë:

22 "Mendoj që është më së mirë që kërkesat e tona të mos
23 jenë të keqinformuara. Shtabi i Përgjithshëm nuk
24 kundërshtohet, në përgjithësi, vetëm disa persona. Nuk besoj
25 që asnjë prej Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së të mos ketë

1 përdor SHIK-ut, që është Shërbimi i Zbulimit Kombëtar për të
2 ushtru presion".

3 Tani do t'ju pyes në lidhje me këtë pikën e tretë. Për
4 dikë prej Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së që ka përdor SHIK-
5 un për të ushtru presion. Por së pari do të shkojmë te
6 konteksti. Në qoftë se e shikoni pikën e fundit, aty është:

7 "Për mua prej sot ai është komandanti i zgjedhur".

8 Të ndalojmë këtu për një moment. Ky takim me datën 13
9 shkurt, komandantët e zonë, e zonave në këtë takim po
10 avanconin dy komandantët të mundshëm të UÇK-së, si udhëheqës
11 të mundshëm. A është kjo e saktë? Propozonin, pra, dy
12 komandantë të mundshëm.

13 PË. Po.

14 PY. Ju propozuat Bislam Zyrabin, a është kjo e saktë?

15 PË. Korrekt.

16 PY. Kurse Ramush Haradinaj propozoi Sylejman Selimin, e
17 saktë?

18 PË. Korrekt.

19 PY. Dhe Sylejman Selimi ishte komandanti i zonës së Drenicës,
20 as është kjo e saktë?

21 PË. Po.

22 PY. Pra, Ramush Haradinaj donte në fakt që njëni prej
23 komandantëve të zonës të ketë mundësi të komandonte si Shtabin
24 e Përgjithshëm ashtu edhe UÇK-në në përgjithësi. A është kjo e
25 saktë? Ai për këtë fliste.

1 PË. Unë nuk e njoh krejt qëllimin e Ramushit, por po dihet se
2 kjo është. Po del se kështu është. Logjika thotë kështu.

3 PY. Po ta shikosh nga një këndvështrim tjetër, znj. Lawson me
4 ju diskutoi një përgjim të bisedës telefonike ku keni fol me
5 një person që kishte komunikuar me Jakup Krasniqin dhe është e
6 dukshme qartë se askush prej jush nuk e ka ditur se kush është
7 komandanti. Dhe pastaj dikush thotë, flet për një person se ai
8 po përpiqet bën shamje për nonat. A ju kujtohet kjo pyetje që
9 jua boni zonja Lawson?

10 Domethënë gjatë pyetjeve shitesë që jua boni znj. Lawson,
11 ajo me ju e diskutoi një përgjim të bisedës telefonike në atë
12 përgjim ju jeni njeni prej folësve. [e pakuptueshme] as ju dhe
13 as folësi tjetër nuk e dinte se kush ishte komandanti i
14 përgjithshëm dhe kjo bisedë kishte të bënte me një dokument që
15 ishte lëshuar me autoritetin e Qeverisë së Bukoshit dhe ju thatë
16 që ai nuk kishte kurrfarë autoriteti në zonë. Kjo lidhet me
17 janarin. Tani jemi në mes të shkurtit kur po zhvillohet
18 negociatat rreth Rambujësë. Dhe në këtë takim të 13 shkurtit,
19 siç na thatë, bëhet fjalë për vendosjen e komandanti zone në
20 krye apo si përgjegjës të Shtabit të Përgjithshëm, a është kjo
21 e saktë?

22 PË. Po.

23 PY. Domethënë, ndërkohë që ju e rekomanduat Bislime Zyrapin, e
24 propozuat, ai i cili ishte në atë kohë anëtar i Shtabit të
25 Përgjithshëm, sepse kishte përvojë ushtarake, Ramushi shkoi

1 edhe një hap më tej dhe sugjeroi që duhet të caktohet në atë
2 pozitë një komandant zone që vepronte rend pranë pozitën e një
3 komandanti të përgjithshëm. Këtë ai e sugjeroi, Ramushi, pra.
4 PË. Po.

5 PY. Dhe në fund mendoj që ju u bindët siç u bindën edhe
6 komandantët e tjerë të zonave që duheshte të fitonte propozimi
7 apo sugjerimi i Ramushit. Domethënë, atë detyrë, ai post t'i
8 jepej Sylejman Selimit.

9 PË. Po, korrekt.

10 PY. Por, kur shohim këtu në fund të faqes, "Për mua ai është
11 komandant i zgjedhur", është se ju faktikisht e pranoni
12 Sylejman Selimin si personi që do të jetë në krye të zinxhirit
13 komandues, mbi Shtabin e Përgjithshëm. A është kjo e saktë?

14 PË. E saktë.

15 PY. Vetëm një minutë, ju lutem. Të shkojmë te pika e tretë:

16 "Nuk besoj asnjë anëtar i UÇK-së nuk e ka përdor
17 shërbimin...", se ka tri herë negacion në atë fjali.

18 A mund, ju lutem, ta lexoni qartë dhe ngadalë në shqip
19 atë pikën e tretë në mënyrë që përkthyesit këtu të mund të na
20 e japin përkthimin e qartë dhe saktë të asaj pjese.

21 PË. Po përpiqem.

22 "Dyshoj se askush nga anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm
23 (SHP) të UÇK-së nuk e ka përdor SHIK-un për të bërë presion".

24 PY. Domethënë, thjesht po përpiqem ta kuptoj këtë negacionin
25 që është përdor disa herë në këtë fjalinë shqip. Ku thuhet se

1 nuk mendoj që dikush prej Shtabit të Përgjithshëm e ka përdor
2 SHIK-un të ushtrojë presion apo doni të thoni që keni mendu që
3 çdokush nga Shtabi i Përgjithshëm e ka përdor SHIK-un për këtë
4 qëllim.

5 PË. Nuk e di çfarë kam mëndu atëherë, por besoj që fjala
6 është që unë paskam dyshuar se dikush e ka përdor Shërbimin
7 Informativ Kombëtar Shqiptar për të bërë presion.

8 PY. Sepse kur jua bëni pyetjet Prokurorja në lidhje me këtë,
9 prezumohej se kishte njëfarë shërbimi zbulimi brenda Ushtrisë
10 Çlirimtare të Kosovës. Por sikur ta kishte parë ajo këtë
11 fjalinë brenda kontekstit nuk do ta kishte bërë pyetjen.

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Unë nuk piketova asnjë shërbim
13 konkret. Ia lashë dëshmitarit pyetjet e hapur.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni me
15 pyetjen z. Emmerson.

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] Të shkojmë te dokumenti 00226353.

17 PY. Është vetëm katër faqe më përpara asaj pjesë që e pamë,
18 në mënyrë që ta shikoni qartësisht kontekstin brenda të cilit
19 është bërë ai koment. Këto janë shënime, nuk dihet se kush
20 është folësi, por është e qartë se është nga i njëjti takim.
21 Dhe kjo çon në atë komentin që është regjistruar me emrin
22 tuaj.

23 Përpara se të kalojmë te kjo është mbledhja e 16 shkurtit
24 kur është qit me armë në ajër. Kjo ishte në pikën më të lartë
25 të konfliktit midis komandantëve të zonave dhe Shtabit të

1 Përgjithshëm gjatë Rambujesë, a është kështu?

2 PË. Deri atëherë nuk është provuar ndonjë problem më i madh.

3 PY. Domethënë, për ta kuptuar kontekstin, ata që ishin kundër

4 ndonjë lëvizje të komandantëve të zonës kundër Shtabit të

5 Përgjithshëm, ishte njëfarë lloji "grusht shteti", si të

6 thuash. A është ajo fjala që përdorën komandantët e zonave

7 kundër Shtabit të Përgjithshëm? Si puç, si grusht shtet?

8 PË. Është përdor kjo, këto fjali janë përdor, por ne s'e kemi

9 pa si puç as grusht shteti.

10 PY. Jo, sigurisht që jo, por ata që u përpoqën që të ndalonin

11 komandantët e zonës nga emërimi i tyre si komandant i

12 përgjithshëm i Shtabit të Përgjithshëm. Ishin ata që përdorën

13 një gjuhë të tillë. Mirëpo, në fakt, komandantët e zonave

14 hoqën autoritetin e Shtabit të Përgjithshëm për të negociu në

15 emër të vetin, a nuk është kështu?

16 PË. Korrekt.

17 PY. Pra, gjatë kohës që ishin në Rambuje, Shtabi i

18 Përgjithshëm apo më mirë të them anëtarët e delegacionit,

19 atyre ua kishin marrë fuqinë, si të thuash, këta të tjerët,

20 komandantët e zonave, sepse nuk kishin më aftësinë për të bërë

21 negociata.

22 PË. Po.

23 PY. Tash do lidhem me dokumentin SPOE00226353. Do të

24 ndërlihem me një bisedë që çon tek pjesa që jua lexoi

25 Prokurorja. Një nga folësit përpiqet të zbusë një pozitë mjaft

1 radikale lidhur me komandantët e zonave. Dhe kjo është në
2 faqen e parë, në krye të faqes:

3 "Po kërkojnë një gjë të tillë në momentin më të
4 papërshtatshëm në historinë e UÇK-së.

5 Do të ishte kjo e arsyeshme në një kohë tjetër. Mirëpo,
6 jo tani. Pyetja që parashtrohet, pse tani kur po ballafaqohemi
7 me zhvillimet më të mëdhaja, gjatë kohës që po zhvillohet kjo
8 konferencë që do të hapi një faqe të re për njerëzit dhe për
9 UÇK-në.

10 Pse kjo çështje ka tërheq vëmendjen e opinionit publik
11 ndërkombëtar dhe të shërbimeve të sigurisë tani.

12 Shërbimet e sigurisë të shumë shteteve si CIA, SHIK-u,
13 Shërbim i Inteligjencës i Shqipërisë dhe UDB-ja, janë në
14 dijeni për këtë takim".

15 Pra, shërbimet e inteligjencës të vendeve të tjera ishin
16 në dijeni për këtë takim. A ju kujtohet që kjo ka qenë njona
17 prej temave që u diskutua në atë takim?

18 PË. Ka pas shumë takime atëherë z. Avokat. Nuk më kujtohet
19 saktësisht kjo, ky debat, por e di që është bo kështu, jam bo
20 ksi debatesh.

21 PY. A pajtoheni me mua se në kontekst të këtij shënime ku
22 thuhet shërbimet sekrete të shumë vendeve si CIA, SHIK-u dhe
23 Shërbimi Sekret i Serbisë, në këtë kontekst SHIK-u, nuk ka
24 ndonjë kuptim tjetër përveçse Shërbimi Sekret i Shqipërisë, a
25 pajtohem me mua?

1 PË. S'mundet me pas tjetër kuptim, përveç Shërbimi Informativ
2 Kombëtar Shqiptar.

3 PY. Tani të shkojmë te faqja tjetër 226354. Si duket është i
4 njëjti folës.

5 "Për foljet dhe interpretimet se do të ketë një puç
6 kundër UÇK-së sonte, janë mjaft shqetësuese për të gjithë ne.

7 Kjo është veçanërisht shqetësuese për qeverinë shqiptare
8 që është e angazhuar tani më se çdo herë tjetër në mbështetje
9 të UÇK-së dhe popullin e Kosovës".

10 Dhe "Reagimi i qeverisë shqiptare" është e shënume me të
11 verdhë në faqe.

12 Ju kujtohet që në këtë takim njerëzit përmendën puçin e
13 dini që dikush e kishte mendimin se shumë shërbime sekrete të
14 vendeve të tjera ishin në dijeni për takimin që do të mbahej.
15 Dhe se një ndryshim i gjithë strukturës në kuptim që ky folës
16 e përshkruan si një puç atë natë. A përputhet kjo që jua
17 thashë me atë që ju kujtohet në lidhje me atë takim? Që ishte
18 mjaft i tensionum dhe vendimtar.

19 PË. Po, më kujtohet, por mua më kujtohet edhe një tjetër se
20 unë kam fol me kryeministrin shqiptar të asaj kohe për këtë
21 qëllim, me Pandeli Majkon. Ju i keni përgjimet dhe me siguri i
22 dini.

23 PY. Kryeministri, kush ishte kryeministri i asokohe?

24 PË. Pandeli Majko, ka qenë shqiptar.

25 PY. Pra, ju folët drejtpërdrejt me të. Ju kujtohet për çfarë

1 keni folur?

2 PË. Për këtë temë, për këtë ndërhyrjen në vendin tonë përmes
3 Shërbimit Informativ Shqiptar, SHIK. Unë besoj që e keni në
4 telefonatat e incizuara.

5 PY. S'jam i sigurt a i kemi në fakt. Po kjo ishte një dëshmi
6 shumë e rëndësishme shtesë sapo na dhatë. Pra, ju personalisht
7 e ngritët telefonin kur mori kryeministri shqiptar. Pra, në
8 thelb ju i thatë atij që largoheni një çikë SHIK-un dhe mos
9 t'u pengojë punën komandantëve të zonave. Pra, të mos u
10 pengojë arritjen e objektivave strategjike komandantëve të
11 zonave, diçka të tillë keni po përpigëni të përshekruani?

12 PË. Kam kërkuar nga ai që më nuk është i njohur me problemet
13 që kemi në brenda, dhe të tërhiqet mos bëjë presion përmes
14 njerëzve të tij.

15 PY. Ju e morët atë në telefon apo ai ju mori ju në telefon?

16 PË. Unë e kam marrë atë.

17 PY. Folët për veten tuaj a folët në emër të të gjithë
18 komandantëve të zonave kur ia parashtruat atë kërkesë?

19 PË. Nuk kam pas autoritet me fol në emër të komandantëve të
20 zonave, por në emër të këtij shqetësimi, këtyne problemeve që
21 po u diskutonin në atë kohë në Kosovë.

22 PY. Faleminderit. Në thelb, pra, i bie, kjo ka qenë para apo
23 pas kësaj mbledhje, ju kujtohet?

24 PË. Po më kujtohet, por rreth këtyne temave kur kemi fol unë
25 kam marrë përsipër me fol me kryeministrin shqiptar.

1 PY. Do flasim më shumë lidhur me këtë, por para se të shkojmë
2 tek kjo. Ne tani e dimë, sepse na treguat se çfarë donin
3 komandantët e zonave nga ky ndryshim, po e quajmë ne. Dhe ju
4 na thatë që telefonuat kryeministrin shqiptar që të
5 siguroheshit që SHIK-u shqiptar të mos e pengonte këtë gjë.
6 Tani dua të shoh si u përgjigj z. Haradinaj ose si reagoi më
7 saktë z. Haradinaj në këtë mbledhje sa i takon Shërbimit
8 Informativ Shqiptar. Është në fillim fare, madje është faqja
9 që jua tregoi dhe znj. Lawson kur ju bëri pyetjet shtesë
10 sqaruese.

11 Shohim SPOE002226357. Këtu z. Haradinaj do që të arrijë
12 në një pikë vendimtare.

13 "Jemi ushtri dhe nuk jemi të interesuar në shqetësimet e
14 qeverive të huaja dhe siguria qoftë edhe e shtetit amë".

15 Për cilin shtet e ka fjalën ai kur thotë "shteti amë"?

16 PË. Vetëm një shtet amë kishin ne, Shqipërinë.

17 PY. Pra, ai thekson dhe thotë, ai verën se:

18 "Këto janë manipulime dhe lojëra".

19 Dhe në fund të faqes thotë, thotë:

20 "Për mua komandant është Sylejman Selimi". Kështu?

21 PË. Kështu është dokumenti.

22 PY. Në faqen tjetër është përgjigja juaj dhe ju për këtë
23 duhet të shohim faqen me numër 26358 dhe është edhe fragmenti
24 që jua tregoi edhe znj. Lawson. Dhe ju përgjigjeni, citoj:

25 "Për mua, Sylejman Selimi është komandant i zgjedhur" -

1 mbyll citimin.

2 Saktë?

3 PË. Po.

4 PY. Atëherë, atëherë u emëruar Sylejman Selimi si Komandant i
5 Përgjithshëm i UÇK-së mbi Shtabin e Përgjithshëm?

6 PË. Po.

7 PY. Dhe në atë kohë ai ishte një komandant zone, i zonës së
8 Drenicës, kështu?

9 PË. Po.

10 PY. Pra, deri në ato momente kishte e kishin kontrollin
11 vendimtar komandantët e zonave dhe përfaqësuesit e tyre, a
12 pajtohesh me mua?

13 PË. Po.

14 PY. Dhe në ato momente, në atë kohë, komandantët e zonave
15 tërhoqën autoritetin e delegacionit të Shtabit të
16 Përgjithshëm; nuk i lejuan më të vazhdonin negociatat në
17 Rambuje, kështu?

18 PË. Po.

19 PY. Faleminderit, kaq pyetje kisha.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

21 Z. Roberts.

22 Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts:

23 Z. ROBERTS: [Përkthim]

24 PY. Mirëdita, z. Mustafa. Unë quhem Geoff Roberts dhe
25 përfaqësoj z. Selimi. Kam disa pyetje lidhur me një temë shumë

1 diskrete sa i takon disa prej përgjigjeve që ju i keni dhënë
2 sot paradite znj. Lawson në pyetjet shtesë.

3 Z. ROBERTS: [Përkthim] Për këtë fillimisht do të shohim
4 intervistës e ZPS-së që është Pjesa 2, faqja 24 në anglisht
5 dhe faqja 29 tek shqipja me ERN082894-TR-AT [sipas
6 përkthimit]. Shkojmë në fund të faqes.

7 PY. Z. Mustafa, sot paradite ju drejtuan një pyetje të cilën
8 do tua lexoj:

9 "PY. Po Rexhep Selimi, çfarë pozite ka pas?

10 "PË. Na kena dyshue që mundet me konë edhe i pari. Ky
11 është opinionimi i imi, por s'e di me saktësi. Unë nganjëherë e
12 kam marrë vesh që ishte komandant në Drenicë. Po flas deri në
13 tetor '98-s dhe ndonjëherë mund të ketë qenë komandant i
14 përgjithshëm".

15 Për ta përfunduar paragrafin:

16 "Pas tetorit '98 ose në tetor të '98-s u bë inspektor i
17 Shtabit të Përgjithshëm. Unë po ju them shumë pozita që i ka
18 mbart më vonë as vetë s'e kanë dit këta që janë asi".

19 E shihni, e shihni vetë në transkriptin tuaj nga
20 intervista me Prokurorinë në ekran, këtë fjali?

21 PË. Po.

22 PY. Pyetja që ju drejtoi znj. Lawson sot paradite ishte:

23 "A pasqyron siç, a e vërteton kjo me saktësi faktin që ju
24 besonit asokohe që komandanti i përgjithshëm ishte Rexhep
25 Selimi?".

1 Ju jeni përgjigjur:

2 "PË. Këto në terma të përgjithshëm apo në mënyrë të
3 përgjithshme janë mendimet e mia, siç e kuptoni edhe nga
4 teksti në tërësi".

5 A ju kujtohet dëshmia që dhatë sot paradite lidhur me
6 këtë?

7 PË. Po.

8 PY. Të jemi të qartë, Rexhep Selimi asnjëherë nuk ju është
9 prezantuar ju personalisht si drejtues apo si komandant i
10 përgjithshëm apo jo?

11 PË. Jo, asnjëherë unë edhe s'e kam thënë këtu kurrë.

12 PY. Dhe asnjë anëtarë tjetër i Shtabit të përgjithshëm nuk ua
13 prezantoi si komandant të përgjithshëm apo si drejtues apo jo?

14 PË. Po.

15 PY. Asnjëherë nuk patë ndonjë dokument gjatë lufte ku të
16 paraqitej ai si komandant i përgjithshëm apo udhëheqës i
17 Shtabit të Përgjithshëm apo jo?

18 PË. E saktë.

19 PY. E saktë, nëse e them që 25 apo 24 vjet që prej luftës, ju
20 asnjëherë nuk keni parë ndonjë dokument ku pretendohet apo të
21 jepet me emër ai si komandant i përgjithshëm apo udhëheqës i
22 Shtabit të Përgjithshëm në '98 apo në '99 apo jo?

23 PË. Korrekt.

24 PY. Tani po e pranoni se opinionimi juaj apo përshtypja juaj
25 asaj kohe ishte e gabuar apo jo?

1 PË. Hamendësime gjatë luftës nuk kanë dalë që janë ashtu siç
2 kam menduar. Unë kam fol për një mendim që kam pas një kohë,
3 përshtypje.

4 PY. Faleminderit. Po ashtu gjatë intervistës keni përmendur
5 që "ndonjëherë kemi dëgjuar që ka qenë edhe komandanti i
6 Drenicës".

7 E pranoni dhe këtë që ka qenë e gabuar, sepse komandanti
8 i zonës Drenicë ka qenë Sylejman Selimi.

9 PË. Po, po.

10 PY. Faleminderit, z. Mustafa. Kaq pyetje kisha unë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 Ka më gjë për të shtuar prej palëve?

13 Trupi Gjykses ka disa pyetje dhe do fillojë Gjykatësi
14 Barthe. Pasi të mbarojë Gjykatësi Barthe do të bëjmë pushimin
15 e drekës dhe do të kthehemi për të parë nëse ka pyetje të
16 mbetura.

17 Vazhdoni.

18 GJYKATËSI BARTHE:[Përkthim] Faleminderit.

19 Pyetje nga Trupi Gjykses:

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirëdita, z. Mustafa. Unë
21 kam disa pyetje për ju dhe pyetje ime e parë është si në
22 vijim:

23 Të premtën gjatë kundërpvetjeve nga z. Misetic, që është
24 Avokati i z. Thaçi, ju thatë si në vijim, dhe unë do të citoj
25 transkriptin e të premtës, faqja 5717, rreshtat 10 deri në 18:

1 "PY. Dhe UÇK-ja që po formonit ju ishte një ushtri krejt
2 vullnetare.

3 "PË. Saktë. Edhe sikur të donim, nëse nuk donim të
4 organizoheshim populli, vetë njerëzit do ta kishin organizuar.
5 Por ishte e rëndësishme t'i udhëzonim njerëzit, t'i
6 organizonim dhe të merrnim, të ndërmerrnim hapat për synimin
7 tonë, që ishte pavarësia e Kosovës.

8 "PY. Vullnetarë, e keni fjalë që njerëzit vinin, kyçeshin
9 e çkyçeshin kur donin?

10 "PË. Saktë. Po, me siguri".

11 Z. Mustafa, a mund të na shpjegoni çfarë keni dash të
12 thoni me këtë? A do të thotë kjo që çdo ushtar i UÇK-së mund
13 të ikte nga fushëbeteja, të linte bashkëluftëtarët e të
14 kthehej në shtëpi kur të dëshironte?

15 PË. Ne jemi përpjek, z. Gjyqtar, me bo rregulla, për me iu
16 tregu atyne që nuk munden, por nëse dikush ka dash të largohet
17 ai është larguar dhe s'e kemi pa më. Ka ndodhë që është
18 larguar dhe kthyer prapë.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Që ta kuptoj tamam, a do të
20 thotë kjo, për shembull, në qoftë se i jepnit një urdher një
21 ushtari, në zonën tuaj operative, ju do të prisnit që ushtari
22 ta zbatonte urdhrin apo pritshmëria juaj ishte që ushtari mund
23 ta refuzonte komplet urdhrin dhe të shkonte në shtëpi, nëse
24 dëshironte, jo ta refuzonte, por të mos e merrte parasysh, të
25 mos e përfillte?

1 PË. Nuk ka qenë aq e thjeshtë për me shkue, por ushtria ka
2 qenë vullnetare dhe ata kanë mund të ikin në shtëpinë e tyre.
3 Ka mund të jenë në rrugë dhe të largohen. Dhe nuk kanë pas
4 pasoja nga veprimet e tyre. Ne jemi mundue të bëjmë rregull;
5 jemi përpjek që urdhrat tona të zbatohen dhe shpeshherë ia
6 kemi arrit.

7 PY. Faleminderit. Pyetja tjetër. Po ashtu, bazuar në
8 transkriptin e të premtës, faqja 5719, rreshtat 5 deri në 7.
9 Ju thatë se ju besoni se ishit ju ofronit mbështetjen
10 logjistike për Shtabin e Përgjithshëm dhe jo Shtabi i
11 Përgjithshëm për ju. Ju kujtohet kjo?

12 PË. Unë kam thonë, dhe kam bërë kështu. Më shumë i jam
13 përgjigjur unë Shtabit të Përgjithshëm për të mira logjistike
14 se këpucë, uniforma, automjete janë përmend atje në proces
15 edhe dy radiolidhje, por edhe pse s'janë të rëndësishme, por
16 unë kam kontribue më shumë për Shtabin e Përgjithshëm. U kam
17 dhënë të mira materiale, logjistike, sesa Shtabi i
18 Përgjithshëm mu, si zonë operative e Llapit.

19 Kam organizuar edhe konvoj me miell pas ofensivave të
20 shtatorit. Është konë problem Drenica me disa pjesë të vendit
21 me u furnizu me miell. Unë konvojin nga Prishtina përmes
22 ndërmarrësve kam organizuar për të dërguar miell për
23 popullatën në Drenicë dhe për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ku i çuat këto konvoj, ku i
25 dërguat këto konvoj?

1 PË. Ishin në regjionet e përfshira në luftë në Drenicë dhe
2 aty ku kishte nevojë, por e di se e kemi marrë një nismë dhe
3 kemi organizuar këto konvoje janë dërguat. Që janë të njohura
4 [e pakuptueshme] këto z. Gjyqtar.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për Shtabin e Përgjithshëm,
6 kështu?

7 PË. Edhe Shtabi Gjeneral ka marrë nga aty të mira materiale.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po përsëris pyetjen: Këto të
9 mira ia keni dërguar Shtabit të Përgjithshëm, në Drenicë? Për
10 shembull.

11 PË. Unë vetëm e kam njoftuar Shtabin e Përgjithshëm se po e
12 marr këtë aksion. Këto të mira materiale ishin me shumicë,
13 ishin shumë dhe ishin për popullatën që ishte në zonën e
14 luftës.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

16 Të premtën ju drejtoi pyetje z. Misetic lidhur me një
17 dokument 16 dhjetor 1998. Kinse i nënshkruar nga kolonel
18 Bislim Zyrapi si shef i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Më
19 konkretisht ka qenë në transkriptin e të premtës, faqja 5742,
20 rreshtat 5. Pastaj faqja 5744, rreshti 9.

21 Sekretare e Gjykatës, a mund të vendosni në ekran provën
22 materiale 1D30. Është SPOE00225260 shqipja, dhe SPOE00225260-
23 ET në anglisht. Faleminderit.

24 Z. Mustafa, ju kujtohet që e patë këtë dokument të
25 premtën?

1 PË. Po e di që e kemi pa.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dokumenti, te paragrafi 1
3 thotë:

4 "Komandantët e zonave operative ta rrisin kontrollin duke
5 angazhuar anëtarët e komandës, komandantët e policisë
6 ushtarake që të bëhet menjëherë ndërprerja e dukurive negative
7 të keqpërdorimit ndaj personave dhe pasurisë private".

8 Së pari, z. Mustafa, me aq sa dini ju, ekzistonte
9 fenomeni i keqtrajtimit të individëve, të personave dhe
10 pasurisë private qoftë në zonën tuaj, por me sa mund të dini
11 ju edhe në regjione të tjera të Kosovës?

12 PË. Mua nuk më kujtohet se ka qenë fenomen asnjëra nga këto
13 dukuri. Me siguri ka pas ndonjë rast që unë mua s'më kujtohet
14 tash.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja e radhës: pse ishte e
16 nevojshme sipas jush që të përgatitje e të shpërndahej një
17 dokument i tillë për komandantët e zonave operative? Pas jush.

18 PË. Nuk, nuk muna me thonë asgjë, z. Gjyqtar. Nuk më vjen,
19 nuk më vjen në mendje tash diçka që kish me mujt me konë pse.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Shohim
21 paragrafin 4 ku thuhet:

22 "Ndalohet arrestimi, paraburgimi ose burgosja e personave
23 pa urdhër të komandantit të brigadës e më lart. Vetëm në raste
24 kritike të situatave luftarake apo kur kryhen vepra penale të
25 ndryshme si ndaj pjesëtarëve të UÇK-së, ndaj individëve dhe

1 pushtetit civil. E shini?

2 PË. Po.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe pyetja ime është: Çfarë
4 do të kishte qenë vepër penale, për shembull. Po ju pyes si
5 ish-komandant i një zone operative, por edhe si jurist. Cila
6 do të kishte qenë vepra penale? Për cilën vepër penale e ka
7 fjalën?

8 PË. Rrezikimi i pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës
9 si dhe i misionit të luftës në përgjithësi.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Bashkëpunimi me armikun a
11 mund të quhet vepër penale? A mund të jetë pjesë e
12 përkufizimit të veprës penale?

13 PË. Kisha, nuk kisha me u shpreh saktësisht, nuk -- e di që
14 është e ndaluar.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Meqë ra fjala, ditën e
16 premtë kur ju bëri një pyetje z. Mistic për që u përmend
17 prapë sot nga pyetjet shtesë të Prokurorisë, ju thatë se ishit
18 në dijeni se sipas Kodit Penal Jugosllav të vitit 1976 dikush
19 mund të dënohej me vdekje për bashkëpunim në kohë lufte. Ju
20 kujtohet që e thatë këtë të premtën?

21 PË. Po. Për bashkëpunëtorë të armikut, kujtohet, kjo po.
22 Është pjesë e Kodit Penal.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Procesverbal, referenca
24 është transkripti i të premtës, faqja 5727, rreshtat 22 deri
25 në 25.

1 Z. Mustafa, a mund të na e sqaroni çfarë keni dashur të
2 thoni me këtë? Ju nuk po sugjeroni që në fakt UÇK-ja ka
3 zbatuar Kodin Penal të Jugosllavisë të '76, në vitin '98, '99,
4 kështu?

5 PË. Në atë kohë, unë personalisht me eprorët e mi, me
6 vartësit e mi nuk e kemi përmend kodin e ish-Jugosllavisë.
7 S'kemi pas pse të ndalemi te kodi. Por e kemi njoh të drejtën
8 në përgjithësi dhe në bazë të drejtës së përgjithshme
9 ndërkombëtare dhe kombëtare kemi marrë vendim për me ndalue
10 secilin që është mundu përpyjek të na dëmtojë neve, të na
11 dëmtojë rrugën për liri, misionin tonë për arsye ushtarake.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Shohim
13 paragrafin 6 të dokumentit që kemi në ekran që në anglisht
14 thuhet:

15 "Ndaj kryesve të veprave penale apo shkeljeve, të
16 shkelësve të disiplinës ushtarake të ndërmerren masa të
17 menjëhershme izolimi, çarmatimi dhe përcjellja në organet e
18 gjyqit ushtarak të UÇK-së".

19 E shihni?

20 PË. Po.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja ime: Jeni në dijeni
22 të ndonjë pasoje si kjo që përmendet këtu, izolim, çarmatim
23 dhe përcjellje në organet e ushtarak të UÇK-së? Besoj se kur
24 ju pyeti Prokuroria të premtën ju përmendët nja dy-tre raste
25 kur ushtarët kanë gjuajtur me armë; kanë gjuajtur me armë apo

1 kur ka pasur konflikte, mosmarrëveshje mes ushtarëve në

2 komandën tuaj, kështu?

3 PË. Po, por që kanë qenë, ne s'kemi pas ku t'i përcjellim
4 para gjyqit ushtarak, sepse gjyqi ushtarak nuk ka funksionu.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju kërkojmë ndjesë, për
6 procesverbal ka qenë transkripti i 12 korrikut 2023, faqja
7 5541, rreshtat 18 deri në 19, 18-19.

8 Pyetja ime e radhës është kjo: A ka pasur raste të tjera
9 ku një ushtar i UÇK-së është izoluar, çarmatosur apo ndjekur
10 penalisht, sepse ka keqtrajtuar ndonjë person të ndaluar. Ju
11 kujtohet kjo?

12 PË. Jo, nuk më kujtohet.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Të premtën gjithashtu gjatë
14 pyetjeve nga Mbrojtja e Veselit, ju thatë, dhe unë citoj:

15 "Në një ushtri të rregullt, urdhrat duhen zbatuar.
16 Megjithatë, edhe urdhrat kur na vinin asokohe interpretoheshin
17 më shumë si rekomandime prej nesh. Ne besojmë se e dinim më
18 mirë situatën në terren, sesa Shtabi i Përgjithshëm".

19 Kjo është transkripti i të premtës, faqja 5767, rreshtat
20 2 deri në 25. Pyetja ime është: Për cilën situatë e keni
21 fjalën? Për situatën ushtarake në terren?

22 PË. Ushtarake, por situata ushtarake në përgjithësi. Ambienti
23 i luftës.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Po ashtu ditën
25 e premtën ju thatë, z. Mustafa, po ashtu bëhet fjalë për

1 transkriptin e të premtes, faqja 5769, rreshtat 1 deri në 3.

2 Citoj:

3 "Lufta mbaroi përpara se të merrte statusin që duhet të
4 kishte Shtabi i Përgjithshëm që t'u lëshonte urdhra
5 komandantëve të vet" - mbyll citimin.

6 Mund të më shpjegoni çfarë keni dash të thoni me këto
7 urdhra, urdhëresa. Urdhëresa për aspekte ushtarake, operacione
8 apo për çdo aspekt të mundshëm?

9 PË. Për çdo aspekt të mundshëm, niveli ma i naltë i UÇK-së,
10 Shtabi i Përgjithshëm, nuk ka mujt me e vu veten në funksion
11 gjatë luftës në Kosovë. Ka përfundue lufta dhe nuk ka mujt me
12 ardh deri aty ku kemi prit ne dhe ku kemi pas dëshirë.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Sipas
14 transkriptit të së premtes, faqja 5745 [sipas përkthimit],
15 rreshtat 7 dhe deri në 9, z. Mustafa, pyetjes së z. Misetiç,
16 ju u përgjigjet se, në 1998 ishte një draft-kushtetutë që nuk
17 hyri asnjë në fuqi dhe kjo u quajt, quhej si Kushtetuta,
18 njihej si Kushtetuta e Kaçanikut. Ju kujtohet kjo?

19 PË. Po, z. Gjyqtar.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na thoni pak më
21 shumë në lidhje me këtë projekt-kushtetutë, kush e përgatiti,
22 kush e hartoi, ku u hartua dhe pse nuk hyni në fuqi?

23 PË. Pas largimit të deputetëve që qeverisë dhe të deputetëve
24 të Kosovës nga institucionet, Kuvendi i Kosovës që nuk
25 pranohej nga ish-Jugosllavia ka përgatit Kushtetutën në vitin

1 1990, që quhet Kushtetua e Kaçanikut. Në fakt ajo e ka
2 preambulën "Kushtetua e Kaçanikut" dhe për e shkruar shkurt
3 dhe qartë, por kurrë nuk ka arrit populli shqiptar me e vu në
4 jetë.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Përsëri po ju pyes, a ju
6 kujtohet se kush e ka përgatit këtë draft, projekt-kushtetutë,
7 kush e ka hartu?

8 PË. Komisioni Parlamentar i Kuvendit të Kosovës të asaj kohe.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

10 [Anëtarët e trupit gjykses këshillohen]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani do të bëjmë
12 pushimin e drekës. Ju lutem, të ktheheni këtu në sallë në orën
13 14.30.

14 Sekretare, mund ta shoqëroni dëshmitarin jashtë sallës.

15 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa për t'ju
17 informuar Gjykatësi Barthe ka edhe disa pyetje. Do të vazhdojmë
18 me ato dhe pastaj do të vazhdojmë me pyetjet e Gjykatësve të
19 tjerë nëse kanë.

20 Shihemi përsëri në 14.30.

21 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.53

22 --- Seanca rifillon në orën 14.30

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

24 Sekretare, mund ta sillni dëshmitarin.

25 [Dëshmitari vijon dëshminë]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
2 uleni.

3 Dëshmitar, do të vazhdojmë me pyetjet e Gjykatësit
4 Barthe, mund të kenë pyetje dhe disa nga Gjykatësit e tjerë.
5 Po i afrohem fundit të dëshmisë tuaj. E çmojmë durimin dhe
6 vëmendjen. Shpresojmë që do të përfundojmë sot.

7 Fillojmë me Gjykatësin Barthe.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
9 Smith.

10 Përsëri mirëdita z. Mustafa.

11 Më dëgjoni?

12 PË. Po.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kam disa pyetje në lidhje me
14 dy persona, Nuredin Ibishin dhe Latif Gashin. Në qoftë se nuk
15 e kam të gabuar, na thatë javën që shkoi se Nuredin Ibishi me
16 nofkën Leka, ishte shefi i shtabit në zonën operative, se
17 ishte vendimi juaj përfundimtar për ta emëruar atë dhe se ai
18 ju raportonte juve.

19 I referohem transkriptit të datës 11 korrik 2023, faqja
20 5484, 8495.

21 A është e saktë kjo?

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Mustafa sipas dëshmisë
24 tuaj që dhatë po atë ditë, domethënë me 11 korrik, ai Nuredin
25 Ibishi, fillimisht ishte komandant i Brigadës 152 dhe se Arif

1 Muqolli në tetor të atij viti e zëvendësoi atë.

2 Kjo është në faqen e transkriptit 5500 rreshti 13.

3 Megjithatë, të premtën gjatë kundërpyetjeve të z. Misetić
4 në emër të z. Thaçi ju konfirmuar në lidhje me atë dokument
5 është prova materiale P00181, se Leka, apo z. Ibishi ishte
6 shefi i shtabit dhe komandant i Brigadës 151 në atë kohë.

7 Pyetja im është kjo: Çfarë është e saktë, a ishte Nuredin
8 Ibishi komandanti i Brigadës 151, apo i Brigadë 152?
9 PË. 152 ka qenë gjithherë, z. Gjykatës.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për fat të keq, z. Mustafa,
11 nuk është kjo që keni thënë gjithnjë, të paktën jo në këtë
12 gjykim apo në këtë sallë të gjyqit. Ju siç ju thashë,
13 konfirmuat kur ju bëri pyetje z. Misetić si Mbrojtësi i z.
14 Thaçi se zoti Leka ose z. Ibishi ishte komandant i Brigadës
15 151. Pra, a je i sigurt që ishte komandant i Brigadës 152 ai?
16 Dhe në qoftë se ai ka qenë komandant i Brigadë 152, atëherë
17 kush ishte komandant i Brigadës 151?

18 PË. Komandant i Brigadë 151 ka qenë Idriz Shabani, Luta.
19 Komandant i Brigadës 152 ishte Leka, Nuredin Ibishi derisa ka
20 ardhë Profa, Arif Muqolli. Më falni nëse kam bo gabim në
21 numra.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pyetja ime me
23 radhë është kjo: Z. Mustafa, a ju kujtohet se kur z. Ibishi u
24 bë komandant i Brigadës 152, dhe kur u bë komandant i shefit
25 të shtabit të juaj, nëse e dini?

1 PË. Kohët mund të lëvizin po ai ka luajtur rolin e
2 komandantit të brigadës nga korriku ose gushti 1998. Kurse
3 dikund te tetori, mundet me kanë, ndoshta edhe më vonë diçka,
4 është bërë shef i shtabit të zonës.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Sa i përket z.
6 Latif Gashi, me nofkën Lafa, ju na thatë që ishte shefi i
7 shërbimit të zbulimit të zonën operative tuajën. A është kjo e
8 saktë?

9 PË. Po e saktë.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe gjithashtu thatë se ju
11 ishit ai që e emëroi atë në këtë post, pra Latif Gashin. A
12 është kjo e saktë?

13 PË. Po, z. Gjyqtar.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kur emëruat në këtë post?

15 PË. Z. Latif Gashin me këta ushtarët që kanë qenë më herët,
16 shokë me mua, janë emëruar më herët. Unë ndoshta z. Latif
17 Gashi e kam lutur të kryejë këtë detyrë dikund nga qershori
18 1998. Kjo do të thotë kujdesi për njësitet, për armatimin
19 tonë, dhe për gjithë njerëzit që ishin me ne atë kohë.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe kur e keni emëruar z.
21 Latif Gashi si shef të shërbimit të zbulimit në nivel të zonës
22 operative? Kur ka ndodhur kjo?

23 PË. Emërimi ka ardhë pas riorganizmit. Mund të ndodhë pak
24 kohë para ofensivës së shtatorit. Mbasi janë kompletu kanë
25 ardhë edhe eprorë të tjerë si Nuredin Ibishi, Kadri Kastrati e

1 shumë eprorë të tjerë që erdhën në zonë, atëherë mund edhe e
2 kam kompletu shtabin më mirë, më shumë. E kam konfirmu edhe
3 një herë.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Dhe pasi që z.
5 Latif Gashi u bë shef i shërbimit të zbulimit çfarë
6 konkretisht bënte ai? Domethënë, cilat ishin detyrat edhe
7 përgjegjësitë e tij si shef i shërbimit të zbulimit në zonën
8 tuaj?

9 PË. Detyrat kuptohet për kujdesin e njësive të zonës dhe
10 informatat aty ku mund të merrnin përmes njësive tona,
11 përmes aktivistëve tanë, ushtarëve tonë. Çdo informatë që ka
12 qenë e vlefshme me marrë, e kemi marrë.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ishte ai gjithashtu i
14 përfshirë në detyrën e mbledhjes së informacionit për
15 bashkëpunëtorë të mundshëm?

16 PË. Ato z. Gjykatës, na vinin nga njësitet në terren. Nga
17 njerëzit që i kishim nëpër çdo fshat. Ne e kemi pasë të
18 mbuluar të gjitha fshatrat të regjionit tonë. Ata njerëz kanë
19 qenë të obligum të raportojnë nëpër njësitet -- nëpër eprorët e
20 vetë deri te shtabi i zonës.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A do të thotë kjo se z.
22 Gashi nuk ishte i përfshirë në mbledhjen e informacionit në
23 lidhje me bashkëpunëtorët e mundshëm?

24 PË. Jo, ai e dinte këtë gjë.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ndoshta është çështje

1 përkthimit, por do ta përsëris pyetjen. A ishte i përfshirë në
2 mbledhjen e informacionit për bashkëpunëtorët e mundshëm apo
3 nuk ishte i përfshirë?

4 PË. Ai ishte i përfshirë. Ishte anëtar i komandës së zonës
5 dhe ishim të gjithë e kërkonim këtë gjë.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit. Z.
7 Mustafa, ku ishte i vendosur z. Gashi apo sektori i
8 inteligjencës, i zbulimit prej tetorit 1998 deri në mars 1999?
9 Në çfarë vendi ishin të vendosur?

10 PË. S'kanë pasë lokacion të veçantë.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po sektori i inteligjencës,
12 i zbulimit a ishte i vendosur në Lllapashticë aty ku ishit edhe
13 ju të vendosur në tetor 1998, nëse më kujtohet saktësisht?

14 PË. Aty ndihmësi i tij Hyzri Talla ka qëndru me mue. Aty kam
15 bërë -- ku kam fjetur unë ka fjetur edhe Hyzri Talla gjithë
16 herët.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po policia ushtarake në
18 nivel të zonës tuaj operative ku ishte e vendosur apo ku e
19 kishte bazën?

20 PË. Gjithherë ka qenë afër meje. Ka qenë siç u kanë caktu nga
21 prokurori apo avokati nuk e di, dikun 200 metra larg bazës
22 time.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe cili ishte raporti midis
24 policisë ushtarake edhe sektorit të zbulimit në zonën
25 operative të juajën?

1 PË. Nuk ka pasur relacion konkret. Z. Gashi ka qenë luftëtar
2 e njohin të gjithë është e njohur në publike. A më shumë ka
3 dashur të jetë në fronte. Ai gjithherë ka fjetë nëpër vijat e
4 frontit dhe ka bërë lëvizje të shumta. Gjithashtu ka qenë i
5 përfshirë në logjistikë po edhe punët e përgjithshme të
6 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Gjatë periudhës tetor 1998-
8 mars 1999 a ishte policia ushtarake pjesë e shërbimit të
9 zbulimit?

10 PË. Jo, z. Gjykatës. Ata ishin policia ushtarake, sektor i
11 zonës operative.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe z. Mustafa cila ishte
13 rela -- cili ishte relacioni, raporti midis Latif Gashit dhe
14 Nazif Mehmetit. A ishte njëri prej tyre epror i tjetrit apo
15 ishin të nivelit të njëjtë?

16 PË. Latif Gashi ka qenë anëtar i komandës dhe ka qenë i
17 barabartë me anëtarë të tjerë të komandës. Nazif Mehmeti ka
18 qenë përfaqësues i policisë, i policisë së zonës operative të
19 Llapit.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Domethënë me fjalë të tjera,
21 Latif Gashi ka qenë epror i z. Mehmeti, këtë po thoni?

22 PË. Jo, nuk po them i Mehmeti po ka qenë i rankuar më lartë.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Gashi?

24 PË. Po.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe supozoj se z. Gashi, si

1 shef i shërbimit të inteligjencës apo të zbulimit në zonën
2 operative të Llapit, ju referohej juve, ju raportonte juve. A
3 është kjo e saktë?

4 PË. Po, z. Gjykatës.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe a ekziston mundësia, apo
6 mund të jetë e saktë që z. Gashi gjithashtu i ka raportu
7 drejtpërdrejtë Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së apo ndonjë
8 anëtar të UÇK-së?

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Kërkoj ndjesë që po ndërhyj në
10 pyetjen, por a mund të jetë -- dua që kjo të jetë më e qartë.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Atëherë po e përsëris. Z.
12 Mustafa, a mund të jetë e saktë që z. Gashi t'i ketë raportuar
13 drejtpërdrejtë gjithashtu dhe Shtabit të Përgjithshëm apo
14 ndonjë anëtar individual të Shtabit të Përgjithshëm apo ju e
15 përjashtoni këtë mundësi krejtësisht.

16 PË. Unë asnjëherë s'kam njohuri që Latif Gashi i ka raportu
17 dikujt jashtë regjionit të Llapit, jashtë zonës ku unë
18 udhëheqja.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Domethënë, nuk mund ta
20 përjashtoni këtë si mundësi, këtë po e thoni?

21 PË. Unë nuk kam njohuri. Kurrë s'kam dëgjuar që z. Latif
22 Gashi ka pasur raportim pranë një anëtar të Shtabit të
23 Përgjithshëm ose Shtabit të Përgjithshëm.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit.
25 Nuk kam më pyetje.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
2 Mettraux.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatës
4 Smith.

5 Mirëdita, z. Mustafa. Kam disa pyetje për ju dhe do ta
6 kaloj bashkë me ju një pjesë të dëshmisë që e keni dhënë në
7 këtu në gjykatë për t'u siguruar se e kam kuptuar drejt
8 mënyrën sesi ka funksionuar zona në atë kohë. A ju kam kuptuar
9 drejt që z. Kadri Kastrati ka qenë zëvendësi brenda zonës? A
10 është kjo e saktë?

11 PË. Saktë.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe sikur që i thatë pak
13 përpara Gjykatësit Barthe, Nazif Mehmeti ka qenë shefi i
14 policisë ushtarake në nivel të zonës, a është kjo e saktë?

15 PË. Po.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe Latif Gashi ka qenë
17 shefi i sektorit të zbulimit për zonën tuaj?

18 PË. Po.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Deri në vdekjen e tij, dhe
20 kësaj do t'u kthehemi pak më pas, Hyzri Talla ka qenë zëvendës
21 i Latif Gashit. A është kjo e saktë?

22 PË. Nuk mund me i thënë zëvendës po ata kanë punu shumë afër
23 me njëri-tjetri. Janë konë bashkë. Mundem me thonë që [e
24 pakuptueshme]. Hyzri Talla ka qenë i plafinikuar, e kam thënë
25 edhe më herët, për me ardhë si person i rëndësishëm në zonë.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po a është e drejtë të
2 thuhet se ai ka qenë vartës i Latif Gashit, apo ka vepru si
3 vartës i Latif Gashit deri në vdekjen e tij në fund të 1998?
4 PË. Po e themi dhe ashtu, mundemi me e thanë.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë kam një dokument këtu
6 që sugjeron se z. Talla ka vdekur me 4 dhjetor 1998. A
7 përputhet kjo datë me kujtesën e juaj në lidhje me këto
8 ngjarje?

9 PË. Po.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe një javë më pas mendoj
11 që i bie me 11 dhjetor të atij viti, ju keni nxjerrë një
12 kumtesë për shtyp ku raportohet për vdekjen e tij. Është prova
13 P51. A ju kujtohet ky dokument?

14 PË. Më kujtohet që kam nxjerrë dokument për të, por tash kam
15 harrru, e kam harrru atë dokument. Nëse e shoh unë e di që është
16 ai ose jo.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mendoj që nuk ka nevojë
18 për këtë, por a ju kujtohet se atje keni theksuar se ai ka
19 dhënë një kontribut të rëndësishëm në zonën tuaj gjatë kohës
20 që ka qenë gjallë. A ju kujtohet të keni thënë një gjë të
21 tillë?

22 PË. Po, kam mujt me e thënë këtë në çdo moment.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe sa për të qenë të
24 qartë, përveçse ka qenë si një farë lloj ndihmësi i z. Gashit
25 brenda sektorit të zbulimit, a është emëruar z. Talla në

1 ndonjë post tjetër, apo pozitë tjetër brenda atij sektori?

2 PË. Jo, z. Gjyqtar.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe më duhet një qartësim
4 në lidhje me rolin e Fatmir Humollit sepse me sa e kuptoj unë
5 ai ka pasur dy funksione të ndryshëm. Dhe ju lutem më
6 korrigjoni në qoftë se nuk e kam kuptuar qartë.

7 Fatmir Humolli ka qenë ndihmëskomandant për moral prej
8 qershor 1998 deri në tetor 1998 dhe pastaj komandant i
9 administratës civile nga tetori 1998 e më pas. A është kjo e
10 saktë?

11 PË. E saktë është, këto mua më ngatërrohen kur folja me
12 Prokuroren për Valon Muratin dhe Fatmir Humollin.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk ka problem. Dua ta kem
14 gjithashtu të qartë atë që e keni thënë dhe përsëri ju them,
15 më korrigjoni në qoftë se nuk ju kam kuptuar drejtë. Mesa e
16 kuptoj unë ju keni pasur besim të plotë në këto vartës që i
17 përmenda dhe ju i keni dhënë pak a shumë një farë lirie në
18 mënyrën sesi i kanë kryer detyrat apo përgjegjësitë e tyre.
19 Kështu kuptuar unë dëshminë tuaj. A e kam kuptuar drejtë?

20 PË. Po, z. Gjykatës.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe na shpjeguat se keni
22 krijuar disa sektorë në nivel të zonës dhe nuk do t'i përmendi
23 të gjitha, kjo është në dëshminë tuaj të 11 korrikut, prej
24 faqes 5 e mëtej. Ju i krijuat këto sektorë, domethënë
25 logjistikën, moralin, zbulimin dhe kështu me radhë. A është e

1 vërtetë se kur i krijuat këto sektorë edhe emëruat persona apo
2 dikënd që t'i ndihmonte ato sektorët apo t'i drejtonte ata
3 sektorë?

4 PË. Po, ashtu edhe e kam thënë.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ndoshta po ju bëj një
6 pyetje të dukshme, por a ju kam kuptuar drejtë, domethënë që
7 ata nuk ka mund të ketë një farë sektori pa një shef të
8 sektorit. A është kjo e drejtë?

9 PË. E drejtë është.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe ata sektorë ju
11 referoheshin apo ju raportonin juve dhe shefit të shtabit të
12 zonës, z. Ibishi. A është kjo e saktë?

13 PË. Po.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe një pyetje më
15 gjeografike, të thuash. A e kam kuptuar drejtë që edhe
16 Podujeva ka qenë brenda zonës së përgjegjësisë, gjeografikisht
17 flas, së zonës tuaj?

18 PË. Po.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani do t'i kthehem z.
20 Mehmeti, Nazif Mehtemi. Ju përgjigjet disa pyetjeve që i bëri
21 kolegu im Gjykatësi Barthe, se ka qenë shef i policisë
22 ushtarake. Të martën që kaloi me 11 korrik 2023, në faqen 107,
23 të transkriptit të përkohshëm, ju u pyetët se kujt i raporte
24 Nazif Mehmeti e nga ZPS-ja edhe ju përmendët që ai i
25 raportonte shefit të shtabit të zonës. Domethënë, zëvendësit

1 të jua j dhe juve vetë. A ju kujtohet kjo përgjigje?

2 PË. Po.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mbas asaj që ju pyeti
4 Gjykatësi Barthe, a është e drejtë të thuhet se z. Mehmeti
5 gjatë asaj kohe ka qenë vartës i z. Latif Gashit dhe i ka
6 marrë urdhrat prej tij dhe i ka raportuar atij. A është kjo e
7 drejtë?

8 PË. Nuk e kam të qartë.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do tua bëj shumë të qartë,
10 nuk është problem. Ka një deklaratë apo deklarata që i ka
11 dhënë z. Mehmeti --

12 Dhe numri i këtyre dokumenteve është -- të paktën njërit
13 prej tyre është SITF0069032. Është deklarata e tij që e ka
14 dhënë me 28 janar 2002. Dhe aty pyetet që lidhjet që ka pasur
15 me raportin që ka pasur me z. Latif Gashi dhe ai përgjigjet:

16 "Sipas hierarkisë, zinxhirit të komandës, unë kam qenë
17 përgjegjës përpara shefit të SHIK-ut, Latif Gashit. Nofkën e
18 kishte Lata".

19 Dhe pastaj pyetet:

20 "Kush mund t'ju jepte juve urdhra?"

21 Dhe ai përgjigjet:

22 "Komandant Lata dhe komandant Remi, komandanti i zonës së
23 Llapit."

24 A është kjo dëshmi e z. Mehmeti, pra sipas mënyrës ai si
25 i ka kuptuar gjërat se ai ka qenë përgjegjës përpara shefit të

1 SHIK-ut, z. Latif Gashi dhe se i ka marrë urdhrat prej tij në
2 përputhje me urdhrat e juaj?

3 PË. Unë besoj që edhe z. Nazifi e ka pasur të qartë se ka
4 raportuar pranë shtabit të zonës, që është pranë shtabit që
5 unë e udhëheqja. Tash unë nuk do ta komentoj deklaratën e tij
6 para gjyqit.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë thjesht po ju pyes në
8 qoftë se mënyra si i keni kuptuar ju gjërat ndryshon prej
9 mënyrës si i ka kuptuar ai. Në deklaratën që i është dhënë
10 ZPS-së ai thotë:

11 "Latif Gashi ishte njëri nga eprorët e mi."

12 A është mendimi juaj i ndryshëm prej mendimit të vetë z.
13 Mehmeti në lidhje me z. Gashi, përkatësisht se ai ka qenë
14 njëri prej eprorëve të z. Mehmeti në atë kohë.

15 PË. Z. Gjyqtar, mënyra e zakonit, sektorët raportojnë - ka
16 qenë - shtabit, shefi i shtabit, zëvendësit dhe mua. Nuk e kam
17 të qartë çfarë ka menduar z. Mehmeti tash me këtë rast. Kurse
18 anëtarët e komandës janë kanë më lart të ranguar se vetë z.
19 Mehmeti.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë do t'ju pyes
21 kështu: Kur ai thotë se ka marrë urdhra prej Latës, prej Latif
22 Gashit, atëherë për këtë ju nuk keni qenë i vetëdijshëm, nuk e
23 keni ditur që ai ka marrë urdhra prej Latif Gashit. A ju
24 kuptova drejtë?

25 PË. Asnjëherë s'e kam ditur. Po, drejtë.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe Latif Gashi ishte një
2 vartës i juaji, a është kjo e saktë?

3 PË. Po.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe me krijimin e njësisë
5 së policisë ushtarake brenda zonës operative të juajën, ishte
6 në fakt zbatim i udhëzimeve që morët në këtë drejtim prej
7 Shtabit të Përgjithshëm. A është ky një sugjerim i drejtë? Një
8 propozim i drejtë?

9 PË. Mund me kanë i drejtë edhe pse ne kishim filluar edhe
10 para këtij sugjerimi të konsolidonim policinë ushtarake në
11 zonë.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po, për të qenë të qartë,
13 ju morët udhëzim nga Shtabi i Përgjithshëm për të krijuar
14 njësinë e policisë ushtarake --

15 PË. Po.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] -- dhe këtë e bëtë, e
17 kryet si detyrë dhe njësia u krijuar. A është kjo e saktë?

18 PË. Po.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani do t'ju bëj një
20 pyetje në lidhje me diçka tjetër me ç'ka ju bënë pyetje juve.
21 Dhe kjo është për kohën kur emëruar z. Latif Gashi si shef i
22 sektorit të zbulimit. Dhe mendoj që të martën kur dëshmuat,
23 javën që shkoi, thatë që nuk ju kujtohet data e saktë. Unë do
24 të përpiqem që ta gjejmë, t'i afrohem asaj date bashkë.

25 Së pari do t'ju pyes kështu. A është e saktë se përpara

1 emërimin të z. Gashi si shef i sektorit të zbulimit në zonën
2 tuaj, a kishte dikush para atij domethënë, që ishte në atë
3 post, që e mbante atë pozitë të shefit të shërbimit të
4 zbulimit?

5 PË. Jo, z. Gjyqtar, deri në kohën kur po flasim ne kemi qenë
6 shokë që jemi përpjekur bashkarisht t'i bëjmë të gjitha
7 detyrat edhe në atë mes shokësh unë jam dalluar pak më shumë
8 dhe kam marrë pozicionin e komandantit. Kështu ka ndodhur.

9 Është interesant të shpjegohet se forma nga themelimi i
10 UÇK-së deri te vendimet që pasojnë krejt ka fundi i luftës.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Me gjithë respektin, nuk e
12 kisha fjalën për ju personalisht, e kisha fjalën për Latif
13 Gashin. Unë kam një deklaratë nga shefi i moralit, z. Humolli
14 që thotë, citoj:

15 "Latif Gashi ishte përgjegjës për këtë pozitë, shefi i
16 zbulimit qysh prej formimit që nga krijimi i zonës operative
17 të Llapit".

18 A është kështu? Pra, gjatë të gjithë kohës e ka pasur z.
19 Gashi këtë pozicion, nuk e ka pasur askush përpara tij këtë. A
20 është kjo një deklaratë e saktë?

21 PË. Po z. Gjyqtar, unë edhe më herët e thashë këtë, që edhe
22 para konfirmimit të vendimit ai e ka luajtur këtë rol me
23 autorizimin e shoqërisë, me autorizimin tim.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dëshiroj t'ju pyes për një
25 rast konkret dhe do ta përmendim disa herë. Javën e kaluar, të

1 mërkurën, konkretisht, më 12 korrik ju bënë një pyetje lidhur
2 me këtë. Bëhet fjalë për lirimin e Milovan Stankoviçit. A ju
3 kujtohet që u diskutua kjo gjë?

4 PË. Po.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më duket se i the Trupit
6 Gjykses që u arrestua bazuar mbi hamendësimin se vepronte për
7 llogari të shërbimeve të brendshme serbe, kështu? Të sigurisë
8 - më falni - kështu?

9 PË. Jo, z. Gjyqtar. Ai ka ra i veshur në uniformë serbe, i
10 armatosur me armë zyrtare serbe në pozicionet e ushtarëve të
11 mi dhe ai është kapur në pozicionet tona.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të jemi të qartë, u
13 arrestua për shkak të kësaj uniformës dhe që kishte armë dhe
14 jo se kishte dyshime që kishte lidhje me sigurinë -- shërbimin
15 e sigurisë serb. Kështu?

16 PË. Ushtarët nuk e kanë njohur kur ka rënë në pozicionet
17 tona, fare. E kanë trajtuar si një person i armatosur dhe me
18 uniformë armike dhe sigurisht që e kanë arrestuar dhe e kanë
19 sjellë në policinë ushtarake. Më vonë është bërë e njohur se
20 ai është punëtor -- roje pylli. Ka treguar ai vetë. Dhe e kemi
21 ditur që është punëtor i sigurimit publik serb, si rojtar i
22 pyllit që ka mujt. Ne kemi pasë dyshim që edhe me detyra
23 shtesë.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptoj. A mund të shohim
25 provën materiale P167. Është me ERN U001-0504-U001-0504-ET dhe

1 me të njëjtin numër reference është edhe shqipja.

2 Ka disa aspekte që dua të shohim bashkërisht në këtë
3 dokument. Është e drejtë të them që ju e njihni këtë dokument?

4 PË. Nuk e njoh.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Por e keni parë gjatë
6 gjykimit tuaj në Kosovë. A ju kujtohet ta keni parë atëherë
7 këtë dokument, gjatë gjykimit tuaj?

8 PË. Nuk më kujtohet z. Gjyqtar.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju kujtohet mbase ta kenë
10 diskutuar gjatë intervistës me ZPS-në?

11 PY. Më lejoni ta lexoj dhe unë po mendohem me e rikujtu.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Patjetër. Lexojeni dhe më
13 thoni kur ta keni mbaruar.

14 PY. Nuk po mundem me e kujtue z. Gjyqtar.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në rregull. Sidoqoftë do
16 t'ju bëj disa pyetje. Së pari shkojmë në fund. E shihni
17 nënshkrimin në të djathtë të faqes tek shqipja? A e njihni atë
18 nënshkrim.

19 PË. Jo, nuk e shoh. Unë e pashë edhe më herët, nuk e njoha.

20 Për atë po them që nuk mundem me e njoh këtë dokument.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dokumenti thotë që hetimi
22 lidhur me pretendimet kundër Stankoviç u kryen nga shërbimi
23 informativ sekret i zonës suaj operative. E shihni?

24 PË. Po, po e lexova dokumentin përgjithshëm

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kjo tregon që sektori

1 ishte funksional në atë kohë, apo jo?

2 PË. Në këtë kohët s'besoj që bëhet fjalë për funksionalitet
3 të këtij sektori.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ama ishte aq funksional
5 apo aq operacional sa për të hetuar rastin e Stankoviçit apo
6 jo?

7 PË. Z. Kryetar, krejt biseda me z. Stankoviç ka qenë
8 administrative, nuk ka pasur hetim lidhur me këtë person. Ai
9 ka qenë i armatosur, i uniformuar, me distinktiv të armikut
10 dhe ne s'kemi pasë kurrfarë çfarë të hetojmë me të.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nëse nënshkrimi në atë
12 dokument nuk është i juaj, mund të më thoni kush tjetër mund
13 ta ketë pasur autoritetin për ta liruar z. Stankoviç?

14 PË. Z. Stankoviç besoj që e kam liruar unë, por unë kësij
15 letre nuk kam shkruar.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Jeni i sigurt që e liruat
17 ju z. Stankoviç apo supozoni tani?

18 PË. Ose më kanë treguar se është liruar. Domethënë, nuk ka
19 qenë e rëndësishme për mua të mbaj mend me saktësi.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do të flas pak më vonë për
21 këtë, po a ka mundësi të jetë liruar nga shërbimi informativ?

22 PË. Pa e pyet shtabin e zonës, nuk ka mund askush z. Gjyqtar.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Për një çast do ta trajtoj
24 edhe këtë.

25 A ju kujtohet kur ju bëri pyetje Prokuroria lidhur me

1 vizitën e anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm rreth periudhës
2 17-18 gusht 1998 dhe ju treguan edhe një fragment libri lidhur
3 me këtë vizitë?

4 PË. Më kujtohet se kemi folë për këtë çështje.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet që një pjesë
6 e delegacionit nga zona juaj, z. Talla, z. Gashi, z. Latif
7 Gashi, pra z. Talla dhe z. Gashi kanë qenë anëtarë të
8 delegacionit tuaj në takime? Nëse nuk ju kujtohet mund t'ju
9 tregojmë edhe fragmentin përkatës të librit.

10 PË. Më kujtohet, z. Gjykatës.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, a është e drejtë siç
12 e kuptoj unë - unë e kuptoj që ata kanë qenë të pranishëm në
13 këtë mbledhje në mes të gushtit 1998 në cilësinë e tyre
14 përkatës si shef i sektorit të zbulimit dhe unë nuk po përdor
15 fjalën "zëvendës" por po them si "vartës të z. Gashi". Është
16 kështu?

17 PË. Ashtu duhet të jetë meqë e tha, kanë qenë aty.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dua t'ju pyes po ashtu për
19 diçka që e keni diskutuar para një çasti me Gjykatësin Barthe.
20 Dhe bëhet djalë për procesin e identifikimit të ashtuquajturve
21 bashkëpunëtorë. Unë në këtë moment do të flas vetëm për
22 nivelin e zonave dhe do ju jap disa supozime për mënyrën sesi
23 kryhej kjo. Ju më thoni a pajtoheni apo jo me sugjerimet e
24 mia. Mbase mund t'ju ndihmojë nëse marrim parasysh një
25 deklaratë që ka dhënë z. Humolli, shefi i moralit.

1 Ai -- mund të më thoni nëse pajtoheni apo jo.

2 Ai thotë:

3 "Ka qenë përgjegjësi e të gjithë anëtarëve të UÇK-së të
4 identifikonin personat që mund të ishin bashkëpunëtorë."

5 A pajtoheni me këtë sugjerim të përgjithshëm?

6 PË. Po.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ai thotë se si hap i dytë
8 pjesëtari i UÇK-së që merrte vesht këtë informacion duhet t'ja
9 përcillte eprorit. A e kuptoni edhe ju kështu?

10 PË. Po, kjo ishte rruga normale.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më pas ai shpjegon se ky
12 informacion i kalonte policisë ushtarake e më tej sektorit të
13 zbulimit ose të inteligjencës. A është kjo në përputhje me
14 botëkuptimin tuaj lidhur me këtë pikë? Edhe ju kështu e keni
15 kuptuar?

16 PË. Vetëm unë e di se inteligjenca s'ka mujt me u konsolidue
17 mbas vrasjes së Hyzri Tallës asnjëherë.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptoj këtë. po s'po ju
19 pyes për këtë, po ju pyes për këtë: Në momentin që një oficer
20 merr një informacion, ky informacion i kalonte policisë
21 ushtarake dhe sektorit të inteligjencës në mënyrë që ata të
22 ushtronin detyrat e tyre. A është kështu?

23 PË. Për sektor të inteligjencës nuk e di kujna ka mujt sepse
24 s'ka qenë funksional.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do të flas edhe për këtë.

1 Por në këtë fazë, jam një hap më mbrapa. Po përpigem të kuptoj
2 këtë gjë: Në momentin që një oficer i UÇK-së, jo thjesht
3 ushtar terrenit, merr nga një ushtar terreni informata për një
4 bashkëpunëtor të dyshimtë, a është e drejtë kjo që ka thënë z.
5 Humolli. Siç ka thënë në intervistën e tij. Ai ka thënë që kjo
6 informatë i kalonte policisë ushtarake dhe sektorëve të
7 inteligjencës. A është kështu?

8 PË. Po, por sektor të inteligjencës ne nuk kemi pasur të
9 konsoliduar. Ata janë ndalë zakonisht -- zakonisht informatat
10 janë ndalë te komandanti i brigadë, nëse ka qenë diçka më e
11 madhe, ka ardhë edhe deri te shtabi im, te unë.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Flas edhe për këtë. Po
13 diçka tjetër në qoftë se ishte diçka me rëndësi shumë të
14 madhe, përveç jush edhe stafit tuaj ku shkonte?

15 PË. S'kishte ku, ndalej te ne.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do të flas edhe për këtë
17 pak më vonë. Do pyes për këtë skenar të mundshëm. E zënë se ka
18 dyshime për një person. Jepet urdhër që ky person të ndalohet.
19 Unë e kuptova kështu: Ju thatë që çdo anëtar i komandës së
20 zonës mund të jepte urdhër për të arrestuar një bashkëpunëtor
21 të dyshuar. A e kam kuptuar drejtë?

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sërish, më korrigjoni nëse
24 e kam kuptuar siç duhet. Unë me sa kuptova nga dëshmia juaj,
25 ju thatë që ka pasur urdhëresë të përgjithshme për të

1 arrestuar bashkëpunëtorët e dyshuar, personat e dyshuar si
2 bashkëpunëtor - më falni - dhe kjo urdhëresë kishte ardhur nga
3 Shtabi i Përgjithshëm. A e kam kuptuar drejtë?
4 PË. Ka pasë një urdhëresë nga Shtabi i Përgjithshëm por nuk
5 ka qenë çështje shumë sensible kjo. Unë po ju them na u
6 lodhëm pas luftës tuj fol për këto punë, po është e
7 ekzagjeruar dhe nuk ka qenë prioritet aspak i ynë.

8 Mirëpo, sido që të jetë, këto [e pakuptueshme] që i kemi
9 thënë, ato kanë ndodhura. Ato ndalime që i kemi bë, i kemi bë,
10 por nuk ka qenë që ne tash me fol shumë për to, sepse edhe nuk
11 dimë -- shumë, shumë nga -- shumë fjalë të thënë për këtë
12 punë. Z. Gjyqtar janë me hamendje, janë me hamendësime.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptoj që nga dëshmia
14 juaj, ju po thoni nuk ka qenë përparësi. Por sidoqoftë ju e
15 keni zbatuar këtë urdhër, saktë?

16 PË. Po, por s'ka qenë -- s'kemi folur na për këtë për ditë,
17 sepse nuk ka ndodhur raste për çdo ditë. Janë të rralla dhe
18 nuk kanë shumë të diskutueshme nëpër organet tona.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Një nga gjërat që kërkoi
20 Shtabi i Përgjithshëm ishte të krijonit shtëpi ndalimi për
21 këta individë ose qendra ndalimi për këta individë, saktë?

22 PË. Ne i kishim, ne e kishim këtë shtëpi ndalimi para se të
23 vinte udhëzimi apo rekomandimi apo edhe urdhëresa siç e quajnë
24 disa.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kur urdhëresa apo

1 direktiva, si të doni ta quani, Shtabi i Përgjithshëm ju
2 kërkoi të krijonit ambiente ndalimi për bashkëpunëtorët,
3 saktë?

4 PË. Po ne e kishim atë ambient.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe nëse e kam kuptuar siç
6 duhet po ashtu ju kërkuan të gjenit një vend të përshtatshëm
7 për këtë shtëpi apo objekt ndalimi, saktë?

8 PË. Po udhëzimi apo rekomandimi që e lexuam ishte i tillë.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju dhe stafi juaj u
10 përpoqët të gjenit vende të përshtatshme kur këto vende nuk
11 ekzistonin, saktë?

12 PË. Ka ekzistuar ky vendi, z. Gjyqtar.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] S'ishte nevoja për të
14 gjetur një vend të ri, këtë po thoni?

15 PË. Jo, na veç [e pakuptueshme].

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në këtë direktivë, në këtë
17 urdhëresë të përgjithshme apo udhëzime, ata ju dhanë disa
18 këshilla apo udhëzime se si t'i menaxhonit apo administronit
19 këto ambiente, kështu?

20 PË. Ato që i lexuam ato rekomandime ishin, s'ka pasur të
21 tjera.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po përdor fjalët tuaj, po
23 Shtabi i Përgjithshëm dha udhëzime të përgjithshme për mënyrën
24 sesi duheshin administruar këto objekte ndalimi. Po ajo jo?

25 PË. Po, ato i lexuam sot këtu.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani dua t'ju pyes për
2 procesin e lirimit të të ndaluarve. Si kryhej? Kush e kishte
3 autoritetin për ta bërë këtë gjë? Javën e kaluar thatë që ndër
4 personat që kishin këtë autoritet ishit ju edhe shtabi juaj. A
5 ju kujtohet kjo?

6 PË. Po.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju treguan disa vendime
8 individuale edhe amnisti ku kishit ushtruar këtë kompetencë
9 tuaj për të liruar të ndaluarit. Ju kujtohet?

10 PË. Po.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam një pyetje të
12 përgjithshme, ndaj për një çast do të shohim edhe dokumentin.
13 A mund të na thoni me sa ju kujtohet ju, cila ishte baza që
14 mendonit ju se ju jepte autoritet të lironit të ndaluarit në
15 zonën tuaj operative?

16 PË. Atëherë kur pushonte rreziku që ata mund të sillni mision
17 -- për misionin tonë, për arsye ushtarake. Ata nuk mund të
18 rrezikonin më arsye ushtarake, ne i lironim.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mbase duhej ta kisha pasur
20 më të qartë pyetjen. Është faji im. Nuk po ju pyesja për
21 rrethanat që ju nxisnin të merrnit këto vendime, por po flas
22 dhe po ju flas si jurist tani z. Mustafa, mbi ç'bazë mendonit
23 ju se kishit kompetencën për të liruar personat në rrethanat
24 që sapo na përshkruat. Ku ishte baza për të marrë këto
25 vendime?

1 PË. E njëjta bazë është që i ndalonim, të njëjtat baza i
2 shfrytëzonim për t'i liruar ata. Ata i lironim porsa të
3 mendonim eprorët e mi dhe unë që nuk ka rrezik më misioni i
4 ynë për liri nga ata njerëz. Arsye të përgjithshme z. Gjyqtar.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ta bëjmë më të thjeshtë.

6 Shohim provën materiale P169. ET për anglishten.

7 Shkojmë pak më poshtë tek shqipja.

8 Fillimisht, a mund të na thoni nënshkrimi i kujt
9 komandanti është ky?

10 PË. I njësisë së policisë ushtarake.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të na e thoni
12 emrin?

13 PË. Nazif Mehmeti.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë në krye të
15 dokumentit në të dyja gjuhët.

16 Shihni paragrafin e parë fare në dokument. Pa shkuar tek
17 fjala "Vendim". Paragrafi sipër e shihni?

18 PË. Po.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund ta lexoni me zë
20 cila është baza -- ku është bazuar ky vendim.

21 PË. "Në bazë të Rregullores së Brendshme të UÇK-së,
22 komunikatave të Shtabit të Përgjithshëm, Rregullores së
23 Administrimit Civil si dhe në bazë të Vendimit 001 të
24 komandantit të zonës së Llapit të UÇK-së, mbi amnistinë
25 lëshohet ky vendim."

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ky kjo ka qenë baza me sa
2 kuptoj unë. Bazuar mbi këtë z. Mehmeti vendosi të lirojë
3 individin që përmendet në këtë dokument, saktë?
4 PË. Z. Mehmeti, e thashë edhe atë ditë, kur ka lëshuar
5 dokumenta ka dashë me u pa si zyrtar, dhe i ka shkru kështu
6 qysh i ka shkru. S'kam koment më shumë. Unë asnjëherë para
7 vetes kur kam marrë kësoj vendimesh, kur jam gjind para kësij
8 vendimesh, nuk kam qit as rregullore të brendshme të UÇK-së,
9 as komunikata të Shtabit të Përgjithshëm, as rregullore të
10 administrimit civil, por mbi arsye ushtarake kam thirrë
11 vendime.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do të flasim edhe për
13 dokumentat tuaja pak më vonë. A është sugjerim i drejtë kur
14 them që z. Mehmeti mendonte se ai mund t'i lironte këta
15 persona bazuar në komunikatat e Shtabit të Përgjithshëm dhe
16 rregulloret e Shtabit të Përgjithshëm si dhe bazuar në
17 amnistinë që keni lëshuar dhe ju zotëri, kështu?

18 PË. Z. Kryetar, nuk ka qenë problemi me i liruar. Na mezi
19 kemi pritë me ardhë në pyetje me i liru njerëzit. Ne kemi qenë
20 të angazhum me punë të tjera dhe porsa kanë ardhur informatat
21 se një person s'paraqet problem më për rrethin e tij, ne mezi
22 kemi pritur me e lirue. E kur ka bërë një dokument z. Nazif
23 Mehmeti është dashtë me shkrujt diçka. Unë tash s'mujna me
24 mendu çfarë ka mendu ai.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në rregull. Shohim

1 dokumentin tjetër P225.

2 Kjo është një amnisti. Besoj se jua treguan edhe javën e
3 kaluar me 12 korrik. Kjo ishte amnistia që thatë që ju e keni
4 nënshkruar, saktë?

5 PË. Po.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shohim tek pika 2, është i
7 njëjti numër -- më falni -- shohim emrin. Është i njëjti emër
8 që pamë edhe tek dokumenti që pamë pak më herët që e kishte
9 zbatuar z. Mehmeti. Ju kujtohet emri te pika dy?

10 PË. Po, po më kujtohet.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet që baza që
12 ai mendonte se kishte -- baza që përdori ai dhe përdorte se
13 jepte autoritetin që të lironte këtë person ishte pikërisht
14 amnistia, a ju kujtohet kjo?

15 PË. Po, z. Gjykatës.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shohim paragrafin e parë
17 të vendimit tuaj, para fjalës "Amnisti". Thuhet kështu, sa i
18 takon bazës që është marrë parasysh për të nxjerrë këtë
19 amnisti:

20 "Në bazë të Rregullores së UÇK-së komunikatave të Shtabit
21 të Përgjithshëm, Rregullores së Administrimit Civil dhe në
22 bazë të Vendimit të komandantit të zonës operative të Llapit,
23 vendimi 001 për këta persona shpall e në vijim...".

24 Pra, edhe ju zotëri jeni mbështetur, jeni bazuar në të
25 njëjtat burime, në të njëjta dokumente për të vendosur për

1 amnisti lidhur me të ndaluarit, saktë?

2 PË. Stafi im e ka bo kështu qysh e ka bo, dhe unë s'kam pasë
3 arsye mos me e nënshkru, e kam nënshkru. Edhe s'kam komente të
4 tjera, njëjtë si për dokumentin e Nazif Mehmetit.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Me gjithë respektin, ju
6 keni qenë komandant i kujdesshëm, e keni lexuar, i lexonit
7 vendimet edhe në bazë të këtyre vendimeve, ju jepnit urdhrat
8 para se të nënshkruanit, saktë? Pra, i lexonit pa i
9 nënshkruanit?

10 PË. Kemi dashtë me u liru shumë shpejt prej këtyre personave.
11 Jemi ndjerë mirë që po vjen koha që ata me ikë me u largu prej
12 nesh, dhe normalisht administrata ime, stafi im ka dashtë
13 dokumentet të shihen si të rregullta, të vihet një rregull.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po pyetja ime është: Ju a
15 i lexonit vendimet e urdhrat e amnistitë para se t'i
16 nënshkruanit apo jo?

17 PË. Kam mujt edhe me i lexu po unë kam pasur besim në stafin
18 tim, nuk ka qenë e domosdoshme.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në rregull. Shohim prova
20 materiale P150.

21 Këtë dokument jua treguan po ashtu javën e kaluar të
22 martën dhe besoj se e pranuat se ishte nënshkrimi jua në fund
23 të faqes, kështu?

24 PË. Po, është nënshkrimi im.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kjo është një amnisti

1 tjetër ku urdhërohet lirimi i disa të ndaluarve me datën 17
2 janar 1999, dokumenti. Besoj se shohim në krye të dokumenti,
3 paragrafi i parë, para fjalës "amnisti" thoni:

4 "Në bazë të deklaratave politike të Shtabit të
5 Përgjithshëm të UÇK-së, Rregullores së Brendshme të UÇK-së, si
6 dhe në bazë të Rregullores mbi Administrimin Civil, komandanti
7 i zonës operative të Llapit, shpall..." e vazhdon.

8 Pra, përsëri ju jeni mbështetur në të njëjtën grup
9 dokumentesh për të urdhëruar lirimin e ndaluarve, veç faktit
10 që përveç komunikatave jeni bazuar dhe në deklaratat politike
11 të Shtabit të Përgjithshëm. A është ky një vlerësim i drejtë,
12 një konstatim i drejtë?

13 PË. Ashtu si më ka afruar stafi dokument ashtu i kam
14 nënshkruar. Unë po e shoh që jam përpjekë me bo një dokument
15 të mirë, dokument të rregullt të mbështetur në rregulla.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Por, kompetencën që e keni
17 ushtru për t'i amnestu njerëzit është kompetenca apo
18 autoriteti që buron, apo që bazohet mbi këto dokumente. A nuk
19 është kjo e saktë, z. Mustafa?

20 PË. Kështu është shkruar z. Gjyqtar, por unë ju thashë vetëm
21 arsyet ushtarake kanë mbizotëruar në mendjen time në atë kohë.
22 Edhe ambienti ku ne jetonim këtë dëshironim, që të jetë sa më
23 i mirë, sa më i qetë.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund. të shikojmë pjesën
25 e fundit, në fund të dokumentit.

1 Ju lutem, shikoni aty nga ana e majtë, poshtë faqes. Në
2 të majtë prej vendit edhe datës ka tre rreshta "Evidencës,
3 Arkivit edhe Palës apo palëve". A mund të na thoni një herë se
4 çfarë kuptimi ka "evidenca" çfarë përfaqëson "evidenca".
5 PY. Evidenca është për nevoja të sektorëve tonë, për me i
6 mbajt dokumentat.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po "Arkivi"?

8 PË. Arkiva, vendi ku grumbullohen dokumentet. Dhe për hir të
9 palës së punës është përgatitur dokumenti kështu sepse kemi
10 llogaritur që mund të bjerë në duar të armikut po edhe të
11 publikut, jemi përpjekur të dukemi sa më të rregullt.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe sa për të qenë të
13 qartë, kur thonit "Palët", një kopje të këtij dokumenti i
14 jepej personit që lirohej?

15 PË. Po.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe gjatë kohës që jemi në
17 temën e komunikatave dua të sigurohem që ju kam kuptuar drejtë
18 atë që e keni thënë përpara se u përgjigjët në këto pyetje.
19 Jeni përgjigj disa herë, por dua të sigurohem që ju kam
20 kuptuar drejtë, në qoftë se është e nevojshme do të shkoj tek
21 deklaratat që i keni dhënë.

22 A është e drejtë të thuhet se ju -- se një nga funksionet
23 e simbas jush të komunikatave të Shtabit të Përgjithshëm ka
24 qenë qëllimi i riorganizimit të zonës. A është ky një sugjerim
25 apo konstatim i drejtë?

1 PË. Të lutem e përkthen edhe një herë, gjyqtari e ka thënë
2 mirë por ju -- ju kisha dashtë ta përktheni edhe një herë.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do ta them edhe një herë.
4 Besoj ta them më qartë. Gjatë intervistës me Zyrën e
5 Prokurorit të kësaj Gjykate dhe kjo pyetje është në Pjesën 3,
6 faqja 19, për t'i ndihmuar palët, dhe faqja 25, Pjesa 3 në
7 versionin në shqip.

8 Ju bëhet pyetja:

9 "Kur Shtabi i Përgjithshëm vendosi që duhet të ketë një
10 politikë në lidhje me ndalimin e bashkëpunëtorëve?"

11 Dhe ju përgjigjeni:

12 "Ka pasur komunikata në të cilat kishte paralajmërime që
13 të cilat jepeshin edhe përpara luftës dhe ne i kemi përdorur
14 ato komunikata për qëllimet e riorganizimit.

15 Domethënë, ajo që unë dua t'ju pyes ose ajo që ju pyeta,
16 është nëse një nga përdorimi i këtyre prej anës ju, pra e
17 këtyre komunikatave ishte për qëllime të riorganizimit të
18 zonës?

19 PË. E saktë.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë, a është e drejtë
21 të thuhet, dhe sipas nevojës do t'ju citoj pjesën përkatëse,
22 ato komunikata që Shtabit të Përgjithshëm i keni kuptuar apo i
23 keni interpretuar si autorizim për ju që -- për mënyrën si t'i
24 trajtoni njerëzit që pengonin punën apo aktivitetin e UÇK-së.
25 A është kjo e saktë?

1 PË. S'ka pasë detaje nëpër komunikata për trajtimin e
2 njerëzve, mirëpo ne burime në komunikata e pasë para vedi dhe
3 kemi mendu për to.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ndoshta nuk e kisha të
5 qartë pyetjen. Në intervistën me ZPS-në, është Pjesa 7 e
6 intervistës, faqja 6, aty thoni:

7 "Z. Prokuror ka pasur komunikata edhe para kësaj dhe
8 komunikatat jepnin leje për t'u marrë me njerëzit që e
9 pengonin punën e UÇK-së."

10 A qëndroni pranë kësaj deklaratë që e keni dhënë?

11 PË. Po.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë do t'i kthehem
13 lirimit të personave të ndaluar. Sipas mënyrë si i keni
14 kuptuar ju gjërat dhe në qoftë se e kam gabim, thjesht mund të
15 më thoni po ose jo. Por sipas jush, a kishte leje a ishte i
16 autorizim Shtabi i Përgjithshëm të urdhëronte lirimin e
17 personave të ndaluar?

18 PË. Nuk ka ndodhur kjo gjë.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk ka ndodhur kjo gjë,
20 apo nuk dini për ndonjë rast kur të ketë ndodhur një gjë e
21 tillë?

22 PË. Unë nuk kam dëgjuar kurrë dhe s'kam pasur fërkime me
23 Shtabin e Përgjithshëm për këtë qëllim, për këto çështje.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë mendoj që e dhatë
25 vullnetarisht atë informacion pa u pyetur, përmendët një

1 person me emrin Enver Sekiraqa, në qoftë se e shqiptova si
2 duhet, javët që shkoi gjatë dëshmitë. A ju kujtohet kur e
3 diskutuar këtë person?

4 PË. Po, më kujtohet.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe ai ishte një prej
6 personave të ndaluar që ju kujtohet të jetë mbajtur në ndalim
7 në Majac, a është kjo e saktë?

8 PË. Po.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet se kush e
10 urdhëroi lirimin e këtij personi?

11 PË. Ne me Shtabin e Përgjithshëm kemi urdhnue që të lirohet.
12 Ka qenë koha kur s'kemi pasë më kushte për mbajtjen e tyre në
13 strukt -- në ambientet e tona.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Domethënë, kur thoni "Ne
15 bashkë me Shtabin e Përgjithshëm urdhërum lirimin", kush e ka
16 urdhëruar lirimin, ju apo Shtabi i Përgjithshëm apo kishte
17 konsultim mes jush dhe Shtabit të Përgjithshëm. Si ndodhi?

18 PË. Jo vetëm shtabi im.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë cila ishte
20 përfshirja e Shtabit të Përgjithshëm. Ju thatë "Ne bashkë me
21 Shtabin e Përgjithshëm".

22 PË. Nuk thashë, është përkthimi gabim, s'e kam thënë.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë, do t'ju bëj një
24 sugjerim. Ja ç'ka thonë shefi i policisë ushtarake në lidhje
25 me dhe është në deklaratën që ja ka dhënë Zyrës së

1 Prokurorisë. Citoj:

2 "Ishte me urdhra të Shtabit që ai u lirua."

3 Dhe ai flet këtu për Shtabin e Përgjithshëm.

4 Z. EMMERSON: [Përkthim] Kërkoj ndjesë, a është e mundur
5 që të shikojmë këtë fragment për t'u siguruar në qoftë se
6 bëhet fjalë për Shtabin e Përgjithshëm. Sepse tash po
7 diskutohet pak si më gjatë ky aspekt.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, sigurisht
9 që ka mundësi.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Është dokumenti me numër
11 ERN 05545-TR-ET dhe mendoj që është Pjesa 6. Mendoj që është
12 faqja 21 në anglisht. I kërkoj ndjesë z. Emmerson nuk e kam
13 referencën për versionin shqip. Do ta kërkoj për nevojat e
14 dëshmitarit. Është Pjesa 6, faqja 21.

15 Dhe ndoshta të fillojmë tek faqja 20 për të dhënë pak
16 kontekst në lidhje me përgjigjen.

17 Të shkojmë pak lart faqes. Faleminderit. Edhe pak.

18 Pra, diskutohet këtu, individi, personi në pyetje. Dhe në
19 qoftë se shkojmë pak më poshtë dhe pak më poshtë shpjegohen
20 rrethanat dhe kështu me radhë. Dhe në qoftë se shkojmë tani te
21 faqja tjetër vazhdon diskutimi i rrethanave të lirimit.

22 Dhe pastaj te rreshti numër 5, është pyetja në qoftë se
23 miq, marrëdhënie të mira dhe ai thotë se

24 "Është liruar nga Shtabi i Përgjithshëm dhe se është
25 liruar me urdhër të shtabit."

1 A keni ndonjë arsye ju për ta mohuar këtë, kundërshtuar
2 këtë rrëfim, deklaratë të këtij personi?

3 PË. Është keqinterpretim. Ai ka menduar për shtabin e zonës
4 që e kam udhëhequr unë. Këtë e ka pasur të njohur sepse ne
5 kemi qenë edhe në proces bashkë z. Nazif Mehmeti. Ai e ka
6 ditur këtë gjë mirë. Gabim është evidentuar.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Domethënë, dëshmia juaj se
8 këtu kur përmendet Shtabi i Përgjithshëm është gabim i
9 përkthimit dhe se ai me siguri e ka pasur fjalën për shtabin e
10 zonës. Kjo është dëshmia juaj?

11 PË. Kështu mendoj. Shtabi i Përgjithshëm nuk ka pasur lidhje
12 me këtë çështje.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ka edhe një rast tjetër
14 për të cilën na folët. Është lirimi i Fadil Suleviqit. A ju
15 kujtohet kjo?

16 PË. Po.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe na thatë se kishit
18 shqetësime të mëdhaja lidhur me këtë person dhe deshët ta
19 mbanit në ndalim, për shkak të këtyre shqetësimeve. A është
20 kjo e saktë?

21 PË. Po.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe se mbas arrestimit
23 erdhi Shtabi i Përgjithshëm për të bërë hetim lidhur me këtë
24 person. Për të bërë pyetje në lidhje me këtë person. A është e
25 saktë?

1 PË. Shtabi i Përgjithshëm vetëm ka rekomanduar për me lirue
2 sa më shpejt.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Një nga një t'i marrim
4 gjërat. A e dini se kush e informoi Shtabin e Përgjithshëm për
5 arrestimin e z. Syleviq? A e bëtë ju -- e informuat ju vetë
6 Shtabin e Përgjithshëm apo dikush tjetër e informoi?

7 PË. Unë s'e kam bërë por me siguri, Syleviqi kur është
8 arrestu ka qenë shumë njerëz aty, ka pasur plot njerëz të tij
9 që e kanë ditur që UÇK-ja e udhëhequr nga regjioni e ka
10 arrestuar dhe ashtu -- veç po mendoj që ashtu ka mujt me
11 kuptu. Nuk e di mënyrën sesi e kanë dëgjuar ata.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe ju thoni, dhe po ju
13 citoj. Pra, thatë se Shtabi i Përgjithshëm vetëm ka lëshuar
14 rekomandim për ta liru këtë person sa më shpejt që është e
15 mundur. Dhe ju në fakt nuk deshët ta lironit, siç na thatë,
16 mirëpo, e liruat, apo jo mbasi e morët këtë rekomandim?

17 PË. Nuk e kam liruuar, e kemi lirue mbasi ka përfundue lufta.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po javën e kaluar kur po e
19 shikonim procesverbalin e gjykimit në të cilin ju ishit i
20 akuzuar, në lidhje me datat e liritimit dhe ndalimit dhe
21 arrestimit - më falni. Z. Syleviq në fakt thotë që ai u lirua
22 mbas gjashtë apo shtatë ditëve pas arrestimit. Domethënë, diku
23 në gusht 1998 apo shtator 1998. A pajtoheni me këtë?

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] Më falni, ndoshta është gabimi
25 im, po unë nuk e kam të qartë pyetjen. Si duket ka një farë

1 date midis dy viteve.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Mendoj që e thatë gabimisht datën,
3 thatë gusht po mendoj që kishit ndërmjet shtator 1999.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po, ashtu është.
5 transkripti është më i mençur se unë. Ju faleminderit për këtë
6 korrigjim.

7 Pra, z. Mustafa, sipas dëshmisë së z. Syleviq në atë
8 gjykim ku ju ishit i akuzuar ai u arrestua dhe u lirua dikund
9 në gusht 1998 apo shtator 1998. Me fjalë të tjera, jo mbas
10 përfundimit të konfliktit po pikërisht në mes të konfliktit. A
11 përputhet kjo me atë që ju kujtohet juve, me kujtesën tuaj?
12 PË. Ai nuk është liruar asnjëherë. Gjithherë ka qenë nën
13 kontrollin e njësive të mia ushtarake. Ai ka mujt të jetë i
14 pa prangosur, ka qenë bashkë me ushtarët e mi, por nuk ka qenë
15 i lirë të shkojë në shtëpi apo jashtë territorit ku ishin
16 njësitet e mia.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë, nëse supozojmë se
18 z. Syleviq në fakt është liruar ashtu siç ka thënë edhe ai
19 vetë në këtë gjykatë, kjo do të thotë se ju personalisht nuk
20 keni pasur dijeni për këtë apo nuk keni qenë i informuar për
21 këtë? A është kjo një mundësi?

22 PË. Jam mbajt i informuar gjithherë për këtë çështje dhe ai
23 nuk ka qenë i liruar. Unë me të gjithë dijen që e kam e di se
24 ai nuk ka qenë i liruar. Por, ka qenë gjithherë nën kontrollin
25 e ushtarëve të mi që ai të mos lëvizte pa dijen tonë.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në rregull. Pak përpara e
2 diskutuam çështjen e kompetencave apo të autoritetit të
3 shërbimit të zbulimit për të urdhëruar lirimin e një personi,
4 dhe me sa ju kuptova sipas jush shërbimi i zbulimit nuk e
5 kishte atë kompetencë, nuk e kishte atë autoritet. A ju kam
6 kuptuar drejtë? Pra me fjalë të tjera, sektori i zbulimit a
7 kishte autoritet, kompetencë për të urdhëruar lirimin e ndonjë
8 personi?

9 PË. Jo.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund ta shikojmë
11 dokumentin, SPOE40007895-ET. Është i njëjti numër edhe për
12 versionin shqip pa ET.

13 Zotëri, do të flasim për një çast edhe për aspekte të
14 tjera. Por, dua t'ju jap kontekstin fillimisht. Me sa kuptojmë
15 kjo është një deklaratë që e ka nxjerrë zyra e Adem Demaçit
16 dhe ka lidhje me lirimin e z. Stankoviç. Do ju jap edhe kohën
17 që ta shihni vetë, kohën që ju nevojitet. Por me sa shohim
18 është botuar më 5 tetor 1998, që i bie dhjetë ditë pas liritit
19 të z. Stankoviç, në bazë të vendimit të shtabit tuaj.

20 E shihni këtë?

21 PË. Po.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të shohim çfarë thotë z.
23 Demaçi në emër të Shtabit të Përgjithshëm, është paragrafi i
24 parë pas "Prishtinës, 5 tetor..." ai thotë:

25 "Njoftohemi se më 26.09.1998, shërbimi informativ sekret

1 i UÇK-së i zonës operative të Llapit, në pajtim me direktivën
2 e shtabit të UÇK-së mori vendim që të [e pakuptueshme]
3 Aleksandër Stankoviq të lirohet nga arresti...”

4 E shihni këtë?

5 PË. Po, e shoh.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Thuhet pra, është në
7 përputhje me direktivën e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.

8 Sipas këtij njoftimi për shtyp, këtij artikulli, vendimi
9 për lirimin e Stankoviçit, në fakt është marrë nga shërbimi
10 informativ sekret i zonës suaj. Saktë?

11 PË. Është deklaratë publike e zyrës politike të UÇK-së Adem
12 Demaçi.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po nuk iu përgjigje
14 pyetjes. Pyetja është: Sipas këtij dokumenti vendimi për
15 lirimin e z. Stankoviç u mor nga shërbimit informativ i
16 sektorit tuaj, e saktë?

17 PË. Nuk është e saktë.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk është i saktë sepse ju
19 kundërshtoni përmbajten që po shohim këtu apo mendoni që edhe
20 në këtë rast kemi një problem përkthimi?

21 PË. Unë e di që kam qenë i përfshirë me shtabin tim dhe ne e
22 kemi liruar.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në këtë rast atëherë
24 qëndrimi juaj është që Shtabi i Përgjithshëm nuk është
25 informuar siç duhet se kush e ka liruar z. Stankoviç, kështu?

1 Nuk ka qenë i informuar siç duhet?

2 PË. Shtabi i Përgjithshëm, unë e besoj që s'ka qenë i formuar
3 fare, por zyra e Adem Demaçit ka qenë e informuar. Edhe këtu
4 po flet zyra e Adem Demaçit.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, sipas jush, vetëm z.
6 Demaçi është informuar për këtë lirim, askush tjetër në Shtabi
7 i Përgjithshëm. Kështu po thoni me dëshminë tuaj?

8 PË. Kështu e di unë.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nga e dini ju zotëri? A e
10 dini ju kush ja dha këtë informatë z. Demaçi? Kush ja përcolli
11 informatën për lirim e z. Stakonviç, ju personalisht?

12 PË. Adem Demaçi ka qenë përmes njerëzve të tij, por edhe
13 drejtpërdrejtë në takime të rregullta me ne dhe me njerëz të
14 zyrës së tij. Ai ka pasur një mori këshilltarësh që na kanë
15 vizituar përditë neve. Edhe me siguri informata ka rrjedhur
16 nga stafi im për informim publik.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ta kuptoj saktë dëshminë
18 tuaj, ai është informuar gabimisht ose keqinformuar nga shtabi
19 jua jua sa i takon personit që urdhëruar lirim e z. Stankoviç,
20 saktë?

21 PË. Besoj se ai është i informuar drejt por informatën e ka
22 ndërtuar me këshilltarët e tij sikur ai vetë ka dalë. Nuk ka
23 pasur pse përziej unë me punën e zyrës politike të Adem
24 Demaçit.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po jua bëj pyetjen

1 ndryshe. Sipas jush kush e liroi z. Stankoviç? Ishte një
2 nënshkrim që nuk e dalloje tek urdhri. Kush kishte kompetencë
3 që ta lironte në qoftë se nuk ishte shërbimi informativ?
4 PË. Kompetencë ka pasur shtabi im me mua dhe ne e kemi lirue.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Që të sigurohem që e kam
6 kuptuar saktë diçka që keni thënë, ka diçka lidhur me të
7 ndaluarit. Kur arrestohet dikush si një person i dyshuar për
8 bashkëpunëtor në zonën tuaj, a e kam kuptuar unë saktë që
9 shënohet diku kjo gjë. Ka një dokumentacion për këtë. Një
10 procesverbal për këtë?

11 PË. Ka një shënim administrativ.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Çfarëdo titulli që t'i
13 vendosim, shënimi administrativ apo çdo gjë tjetër. Këtë
14 shënim e bënte policia ushtarake?

15 PË. Kushdo që hasej në te më së pari, por te policia
16 ushtarake edhe shënimet janë përcjellë.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pasi një person i dyshuar
18 si bashkëpunëtor ndalohej dhe merrej atëherë përgjegjësia nëse
19 e kam kuptuar siç duhet, pra përgjegjësia për të verifikuar
20 nëse ka baza për ta ndaluar këtë person ishte përgjegjësi e
21 sektorit informativ, apo të zbulimit. E kam kuptuar saktë?

22 PË. Ishte përgjegjësi e fshatit e terrenit nga ku vinte ai.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E lemë fshatin mënjane. Në
24 momentin që vinin në zonën -- në përgjegjësinë e zonës suaj
25 apo në policinë tuaj ushtarake, apo në përgjegjësinë e qendrës

1 së ndalimit në zonën tuaj. Në momentin që janë aty, kush e
2 kishte përgjegjësinë të verifikonte nëse ekzistonin arsye për
3 ndalimin e personit?

4 PË. Nuk ka pasur proces verifikimi. Policia i ka mirëmbajtur
5 ata, është kujdesur për ushqim, veshmbathje dhe fjetjen e
6 tyre. Kur kanë ardhë informata nga fshati ku është marrë ky,
7 se nuk ka rrezik më, ne i kemi liruar.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju tregoj një
9 deklaratë dhe mund të komentoni lidhur me këtë nëse dëshironi.

10 Është po ashtu nga shefi i policisë ushtarake, z.
11 Mehmeti. Është pyetur për të njëjtën temë.

12 Është materiali 0555535-TR-ET, Pjesa 5, faqja 6, 7 dhe
13 faqja 7 në shqip.

14 E pyesin:

15 "Kur anëtarët e mbrojtjes civile sillnin një person të
16 tillë, a kishte ndonjë procedurë për të verifikuar nëse kanë
17 pasur urdhër për ta bërë këtë?"

18 Përgjigja e tij ka qenë:

19 "Ishte përgjegjësi e SHIK-ut ose detyrë e SHIK-ut kjo."

20 Pra, si e ka kuptuar z. Mehmeti, mirë a keq, z. Mehmeti e
21 ka kuptuar se ka qenë sektori i inteligjencës përgjegjës për
22 kryerjen e këtyre verifikimeve. Ju keni mendim tjetër?

23 PË. Nuk do ta komentoj deklaratën e Mehmetit.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po unë po ju pyes, ju
25 pajtoheni apo nuk pajtoheni me këtë deklaratë?

1 PË. Burimi, informatat për personat që ne i kemi trajtuar
2 kanë qenë vetë popullata dhe vetë njerëzit nga rrethi ku ka
3 ardhur. Të gjitha njësitet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës
4 kanë qenë të autorizuar dhe vigjilente se kush jeton afër
5 vijës së frontit. Gjithë këta njerëz që ne kemi ndaluar kanë
6 jetuar në vijë të mbrojtjes ku ne po e bënim luftën.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk pajtoheni pra me
8 deklaratën e z. Mehmeti?

9 PË. Po, nuk pajtohem sepse s'ka qenë detyrë e veçantë e
10 askujt.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Me kaq e
12 mbyllim seancën për ditën e sotme. Do të fillojmë sërish nesër
13 në orën 09.00.

14 Faleminderit dëshmitar që ishit i pranishëm me ne sot.

15 Sekretare mund ta shoqëroni dëshmitarin jashtë sallës së
16 gjyqit.

17 Ju lutem të mos bisedoni me askënd lidhur me dëshminë
18 tuaj.

19 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

20 Seanca për sot ndërpritet

21 --- Seanca mbyllet në orën 16.03

22

23

24

25